

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7564 E martë 19 Qershor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion **i** Ditës

Pas një periudhe kohore me veprime e qëndrime haptazi të kundërta e armiqësore, erdhi si papritur lajmi i një takimi direkt mes presidentit ...
Vijon në faqen 20

Nga VASIL KURETA

Takimi i Singaporit: Sukses i madh apo dështim i madh



Opinion **i** Ditës

Në vitet 1960, dy ekonomistë të Fondit Monetar Ndërkombëtar publikuan dy studime të veçanta për të dalë në të njëjtin konkluzion. Sipas tyre, çdo vend ...
Vijon në faqen 21

Nga GJERGJ EREBARA

Trilema monetare e Shqipërisë



Kreu i shtetit: Titull i merituar prej kohësh

"Mjeshtër i Madh" për Aleks Luarasin, presidenti Meta: Pioner i arsimit

Dekorohet themeluesi i Kolegjit Universitar "Luarasi", Ruka: Insitucion elitare në vend

VOLTIZA DURO

Themeluesi i Kolegjit Universitar "Luarasi", prof. Aleks Luarasi është dekoruar ditën e djeshme nga presidenti i Republikës Ilir Meta me titullin "Mjeshtër i Madh". Kontributi i tij i çmuar shumëvjeçar për drejtësinë ...
Në faqen 7

KONTRIBUTI I DETYRUESHËM, KUSH KA TË DREJTEN E BARNAVE ME RIMBURSIM

PENSIONISTET, PERFITIMET E SIGURIMIT SHENDETESOR

Të gjitha kategoritë që përfitojnë shërbim mjekësor falas dhe ilaçe pa pagesë, që nga të vetëpunësuarit, të papunët e regjistruar deri tek invalidët



(Në foto) Ministria e Shëndetësisë, Ogerta Manastirliu, duke u takuar pensionistë

Në faqen 9

— VENDIMI I BASHKISË —

Hasi nderon Gafur Mazrekun, Rama: Provokim, prefekti të mos e firmosë

Në faqen 2-3

— AMBASADORJA E BE —

Vlahutin: S'kemi plan për kamp refugjatësh nga Siria në Shqipëri

Në faqen 4

— DEBATI —

Veliaj me urbanistët për Teatrin Kombëtar,

Mirush Kabashi: Është Meka jonë

Në faqen 18

— TIRANE —

Goditet banda e grabitësve, 5 vetë në pranga, mes tyre edhe 1 polic

Në faqen 9

— SHKODER —



60-vjeçari gjendet i vdekur me vrimë në kokë nga fqinji, dyshimi: E vranë

Në faqen 10

Krimi në Milot, 35-vjeçarja akuzohet për vrasje me paramendim. S'dihet ku e gjeti armën

Vëllai i gruas që vrau burrin: Ai e rrihte

"Motra iku nga shtëpia dhe erdhi te ne. Më tregoi shenjat e dhunës"

Violeta kishte vendosur të divorcohej nga bashkëshorti dhe ishte nisur për të shtëpia e saj në Rrëshen për të marrë vajzën dhe rrobat. Me vete mori edhe kunatën, gruan time, që ta ndihmonte me rrobat. Di që kanë pasur konflikte të vazhdueshme dhe për këtë,



motra iku nga shtëpia. Ajo më ka treguar edhe shenjat e dhunës në trup". Kështu ka deklaruar në polici vëllai i 35-vjeçares, e cila mëngjesin e së dielës ekzekutoi me katër plumba pistolette bashkëshortin, Kujtim Donaj. Një ditë pas ngjarjes ...
Në faqen 11

DEKORIMI AKUZAT

Plagosi Azem Hajdarin, atentatori shpallet "Qytetar Nderi", zbardhet motivacioni

"Mazreku", kreu i këshillit bashkiak: Propozimi na erdhi nga bashkia

Kryebashkiaku Lala: Mazerku, ndër më të mirët e Hasit

Valentina Madani

Ish-deputeti dhe anëtar i PS-së, Gafur Mazreku, që plagosi në vitin 1997 në mes të parlamentit shqiptar Azem Hajdarin, dje u shpall "Qytetar Nderi" i Hasit (pas vdekjes). Në propozimin e Bashkisë së Hasit dhe të miratuar nga këshilli bashkiak shkruhet ndër të tjera se Gafur Mazreku duhet të dekorohet për "kontributin e dhënë në ushtrimin e detyrës së besuar nga populli i tij për pushtetin vendor, kontribut i përcuar jo vetëm për popullin e zonës së tij, por për mbarë popullin e Hasit". Ndërsa motivacioni i dhënies së këtij titulli është: "Personalitet intelektual, për kontributin e pasqor në pushtetin vendor". Projektvendi mban firmën e kryebashkiakut Adem Lala, por edhe të juristes e një eksperti në arsimit. Nisur nga kjo, me 13 vota pro dhe 1 abstenim, Këshilli Bashkiak i Hasit shpalli Gafur Mazrekun "Qytetar Nderi" të Hasit, me motivacionin "Personalitet intelektual, për kontributin e pasqor në pushtetin vendor". I pyetur nga "Gazeta Shqiptare" lidhur me arsyet e marrjes së vendit, kreu i këshilltarëve bashkiakë, Agron Xhaferi bëri të ditur se propozimi ka ardhur nga Bashkia e Hasit dhe jo nga këshilli bashkiak. "Kemi marrë propozimin nga administrata e Bashkisë së Hasit, nga kryetari i bashkisë, juristja e bashkisë, nga zyra për çështjet e arsimit dhe kulturës me shkresë zyrtare për ta shpallur z.Mazreku 'Qytetar Nderi' të Hasit. Motivacioni është 'Personalitet intelektual, për kontributin e pasqor në pushtetin vendor'", u shpreh z.Agron Xhaferi. Kurse kreu i Bashkisë së Hasit, Adem Lala tha se Mazreku është një nga figurat më të mira të Hasit dhe se "nuk e kupton pse duhet të debatohet figura e tij". Kurse të djathtët i bënë thirrje prefektit që të



Kryebashkiaku i Hasit, Adem Lala

PROPOZIMI

Në propozimin e Bashkisë së Hasit dhe të miratuar nga këshilli bashkiak shkruhet ndër të tjera se Gafur Mazreku duhet të dekorohet për "kontributin e dhënë në ushtrimin e detyrës së besuar nga populli i tij për pushtetin vendor, kontribut i përcuar jo vetëm për popullin e zonës së tij, por për mbarë popullin e Hasit".

"Keqardhje, babai e fali njeriun që e qëlloi"

Dekorimi i Gafur Mazrekut, vajza e Azemit: Akti, i shëmtuar

Në historinë shqiptare Gafur Mazreku njihet si i vetmi njeri që ka shkrehur një armë në ambientet e parlamentit. Ish-te viti 1997 kur Mazreku, atëherë deputet i Partisë Socialiste, qëlloi në drejtim të rivalit të tij demokrat, Azem Hajdarin, duke e plagosur atë. Për këtë, Gafur Mazreku u dënua me 8 vite burg, ndërsa 21 vite më pas nderohet nga Këshilli Bashkiak i Hasit. E bija e Azem Hajdarit, Rudina, tashmë deputete, tregon si e përjetoi këtë vendim. "Ky është një akt i shëmtuar. Nuk dua t'i futem thellë shumë këtij



debati, sepse i gjithë opinioni publik e di që ky është një akt shumë i shëmtuar për popullin shqiptar. Për vetë faktin se ky njeri ishte i pari që bëri një akt të tillë në parlament. Ky është një njeri që është dënuar dhe është kriminel. Nuk ka hapësirë

për të justifikuar këtë gjë. Por nga ana tjetër, të mos harrojmë se ishte Azem Hajdarin që e fali këtë njeri. Më vjen keq që ne po promovojmë persona të tillë që të lartësohen në këtë mënyrë", u shpreh Rudina Hajdarin për "Top Channel".

mos e miratojë këtë vendim, të cilët e kundërshtuan vendimin dhe akuzuan se votimi u bë gjatë kohës së pushimit në fshetësi nga të majtë. Miftar Dauti, kryetar i këshilltarëve të djathtë deklaroi: "Vendimi është i jashtëligjshëm, pasi vendimi është marrë pa prezencën e këshilltarëve të djathtë. Në kërkum 5 minuta pushim

për konsultime, ndërkohë këshilltarët e majtë e kanë miratuar propozimin e administratës së bashkisë. I bëj thirrje prefektit që të mos e miratojë këtë vendim". Gafur Mazreku më 18 shtator të vitit 1997 brenda ambienteve të Parlamentit të Shqipërisë, pas një shërri verbal dhe më pas fizik me deputetin Azem Hajdarin e plagosi atë me

armë zjarri. Mazreku u arrestua dhe gjykata e dënoi me 12 vite burg. Amnistitë e herëpashershme e ulën dënimin për Mazrekun, i cili llirohet në vitin 2001, tri vite pasi ishte dënuar. Në pranverën e vitit 2002 zgjidhet unanimisht kryetar i PS-së në Has dhe në vitin 2005, ai ndahet nga jeta pas një infarkti.



Azem Hajdarin dhe Gafur Mazreku gjatë konfrontimit fizik në kuvend në vitin 1997

SHKURTE

Dekorimi, Ristani: Rama qëlloi ndaj simbolit të demokracisë

Sekretari i përgjithshëm i PD-së, Arben Ristani aku zoi dje kryeministrin Edi Rama se përmes dekorimit të Mazrekut, qëlloi mbi simbolin e demokracisë. "E kanë marrë mirë mësimin e eterëve, sipas të cilit, populli sundohet duke e varfëruar, dhunuar dhe depersonalizuar. Dekorimi i atij që qëlloi mbi simbolin e demokracisë dhe përdhosi parlamentin duke qëlluar me armë brenda në parlament, në tempullin e demokracisë është pikërisht treguesi më i qartë në drejtim të injorimit, fyerjes, depersonalizimit të atyre që besojnë të herojtë e demokracisë dhe tek institucionet e demokracisë. Gjithsesi, ka akoma që kanë marrë po aq mirë mësimet se si përmbysen diktaturat dhe si përfundojnë diktatorët", shkruan Arben Ristani.

Titulli për Mazrekun, Shehu: Rama lau duart si Pons Pilati

Deputeti i PD-së për qarkun e Gjirokastrës, Tri tan Shehu u është bashkuar reagimeve për vendimin e Bashkisë së Hasit, e cila akordoi titullin "Qytetar Nderi" për autorin e plagosjes së deputetit të PD-së, Azem Hajdarin në vitin 1997. Shehu tha se Rama tentoi që të 'lajë duart' si Pons Pilati. Sipas deputetit demokrat, dhënia e titullit për Gafur Mazrekun është akt i rëndë provokativ. "Së paku, kjo ëveveri duhej menjëherë të dekretonte bilokimin e atij vendimi, ndërsa PS duhej të distancohej qartë nga autorët e ti ndëshkonte ata, që siç duket, si atëherë më 1997-ën dëshirojnë vetëm të provokojnë mbi një krim diabolik, duke e përsëritur atë", shkruan deputeti i PD-së.

Dekorimi, Nishani: Sot u noterizua një akt terrorizmi

Ish-presidenti Bujar Nishani u bashkuar reagimeve për akordimin e titullit "Qytetari i Nderi" për atentatorin e Azem Hajdarit. Përmes një statusi në "Facebook", Nishani tha se sot terrorizmi është noterizuar me mirënjohje nga pushteti politik. "Noterizimi i aktit terrorist ndaj studentit liberator të lindjes së pluralizmit dhe demokracisë në Shqipërinë post-diktaturë konfirmon urretjen dhe revanshin e xhelatëve ndaj një populli që vendosi t'i rrëzojë ata 25 vite më parë pas një kalvari gjysmë shekullor të pushtetit absolut e vrasar", shkruan Nishani.



Dekorimi i atentatorit të Azemit, presidenti: Provokim, evokon konflikte ekstreme

Rama, urdhër prefektit: Vendimi për Mazrekun nuk do firmoset

"Akuzat vulgare, shpërdorim politik i emrit të Azemit"

Valentina Madani

Presidenti i Republikës, Ilir Meta dhe kryeministri Edi Rama reagon ashpër dhe ndaj vendimit të Këshillit Bashkiak të Hasit, i cili shpalli dje Gafur Mazrekun "Qytetar Nderi" të Hasit, me motivacionin "Personalitet intelektual, për kontributin e pasqorë në pushtetin vendor". Vendimi shkaktoi reagime të shumta nga opozita, ndërkohë që edhe kryeministri Rama e ka cilësuar të turpshëm. Për vendimin reagoi edhe Presidenti Ilir Meta, i cili është shprehur se është një provokim i panevojshëm, në tejkalim të vlerave e moralit të shoqërisë sonë. Vetë presidenti nëpërmjet zëdhënësit të tij, Tedi Blushi e dënoi ashpër duke thënë se në këtë mënyrë po shkaktohet një provokim i panevojshëm. "Çdo akt që evokon konfliktet ekstreme dhe dhunën kriminale duhet dënuar dhe evituar në jetën publike. Ky vendim është një provokim i panevojshëm, në tejkalim të vlerave e moralit të shoqërisë sonë dhe perspektivës së saj të qartë europiane. Dekorimi i personave të dënuar me vendim gjykatë për plagosje me armë nuk përputhet me standardet e një shoqërie demokratike", tha z. Meta.



Presidenti i Republikës, Ilir Meta



Kryeministri Edi Rama

ILIR META
"Çdo akt që evokon konfliktet ekstreme dhe dhunën kriminale duhet dënuar dhe evituar në jetën publike. Ky vendim është një provokim i panevojshëm, në tejkalim të vlerave e moralit të shoqërisë sonë dhe perspektivës së saj të qartë europiane. Dekorimi i personave të dënuar me vendim gjykatë për plagosje me armë nuk përputhet me standardet e një shoqërie demokratike", tha z. Meta.

EDI RAMA

Kryeministri bën me dije se i ka kërkuar prefektit të Kukësit refuzimin e firmosjes së atij vendimi, ndërkohë që sot në mbledhjen e grupit parlamentar e ka dënuar këtë shfaqje të shëmtuar papërgjegjshmërie të këshilltarëve të Hasit, pavarësisht se në Këshillin Bashkiak të Hasit, Partia Socialiste ka vetëm një këshilltar, i cili nuk ka votuar pro vendimit.

"Shqiptarët, në revoltë për largimin e Ramës"

Berisha: Rama ekzekutoi për së dyti tribunin legjendar, Azem Hajdari

Ish-kryeministri Sali Berisha dënoi skandalin e Bashkisë së Hasit, e cila i akordoi titullin "Qytetar Nderi" Gafur Mazrekut, autorit të plagosjes së ish-deputetit të PD-së, Azem Hajdari, në sallën e Kuvendit në 1997. Berisha theksoi se Rama e ekzekutoi për së dyti tribunin legjendar Hajdari. Ai u bën thirrje qytetarëve shqiptarë që të ngrihen për vendime më të mëdha dhe me revoltë të largojnë nga pushteti Ramën. "Pas këtij akti kriminal, të denjë vetëm për narkoshtetin e Noriegës, ky i fundit që kishte urdhëruar dy javë më parë vendimin, për të larë duart si Pilati, deklaroi se ky është një turp dhe se ai nuk dinte gjë?! Me këtë deklaratë, Edi Rama dëshmon se është një mashtrues faqezi, që pasi i shpalli luftë opozitës, nderoi dhe përligji krimin politik dhe vrasjen, tani kërkon të lajë duart si Pilati, mbrohet për krimin e tij të shëmtuar! Aktin e sotëm (djeshëm) jo vetëm e ka urdhëruar ai vetë, por gjatë këtyre ditëve lajmin për vendimin e kanë të gjitha mediat, edhe ato që paguhen prej tij!", tha z. Berisha. Sipas tij, ky akt kriminal dhe lufta ndaj opozitës shqiptare është një apel për vendimet më të mëdha për qytetarët shqiptarë, që me revoltën e tyre të largojnë me çdo kusht horrin, vrasësin për së dyti të Azem Hajdarit, kreun e meduzës që e shndërroi Partinë Socialiste në parti droge, bandash, vrasësi, kriminelësh dhe ndërtoi narkoshtetin dhe shndërroi në Shqipëri krimin në sistem për të shtypur shqiptarët dhe dekoruar vrasësit dhe kriminelët.

**GG
GENT STRAZIMIRI**

"Vendimi për të nderuar vrasësin e Azem Hajdarit është gjest revanshi i bijve të kupolës së bandës së xhahliëve, që sundoi për 46 vjet mbi gjakun e këtij populli; i biri i vrasësit të Havzi Nelës duhet ta dijë se po shkon me shpejtësi drejt një, dhe vetëm një fundi të pashmangshëm, fund në të cilin do ta marrë përgjigjen në emër të të gjallëve dhe të të vdekurve të kësaj partie e që po e kërkon me ngulm!", tha deputeti i PD-së.

KRYEMINISTRI

Kryeministri Edi Rama e konsideroi provokim të papërgjegjshëm vendimin e Këshillit Bashkiak të Hasit për t'i dhënë titullin "Qytetar Nderi", Gafur Mazrekut. Rama i quajti hordhi vulgare akuzat e Partisë Demokratike, si një shpërdorim politik të radhës të emrit e të kujtimit të Azem Hajdarit. Në një reagim të shpërndarë nga zyra për shtyp e kreut të qeverisë thuhet: "Kryeministri Edi Rama shpreh keqardhjen për sulmet e shëmtuara ndaj tij, lidhur me një vendim të Këshillit Bashkiak të Hasit, me të cilin ai jo vetëm s'ka asnjë lidhje, por e konsideron një provokim të papërgjegjshëm të kujtudo që

Rama i kërkoj prefektit të mos firmosë për Mazrekun

Dekorimi, PD: Kryeministri të shkarkojë kryebashkiakun e Hasit

Deklarata e kryeministrit Edi Rama se ka urdhëruar prefektin e Kukësit të mos firmosë dekorimin e Gafur Mazrekut "Qytetar Nderi" nuk mjafton për PD-së. Përmes një deklaratë për mediat, PD i kërkon shefit të qeverisë shkarkimin e kryebashkiakut socialist të Hasit. Derisa të bëjë këtë akt të vërtetë distancimi, PD e konsideron Edi Ramën si urdhëruesin e dekorimit të atentatorit të Azem Hajdarit, për të cilin shprehet se do të mbajë përgjegjësi personale. "Asgjë nuk mund ta justifikojë Edi Ramën në vendimin kriminal për të dekoruar njeriun që qëlloi me armë brenda sallës së parlamentit liderin e Lëvizjes Studentore, Azem Hajdari. Firma e prefektit nuk është zgjidhja. Është vetëm një mjet që Edi Rama të mos marrë përgjegjësi. Edi Rama nuk mund të lajë duart si Ponc Pilati dhe të fshihet pas prefektit, sepse kryetari i Bashkisë së Ha-



AKUZA

Sipas PD-së, asgjë nuk mund ta justifikojë Ramën me vendimin e tij kriminal, ndërsa për të justifikuar veprimin, ai duhet të shkarkojë kryetarin e Bashkisë së Hasit, që vjen nga radhët e PS. Madje, Kryeministria pohoi se Rama është angazhuar në këtë çështje dhe i kërkon prefektit të Kukësit të mos e firmosë vendimin.

sit është i tij, se ai ishte në dijeni të propozimit të kryebashkiakut të tij dhe mbi të gjitha, Edi Rama ka në dorë ta shkarkojë atë. Që të tregojë distancim të vërtetë prej vendimit kriminal, Edi Rama duhet ta shkarkojë kryetarin e Bashkisë së Hasit, përfaqësues i PS, i zgjedhur nga Edi Rama. Të ruajë të njëjtin standard si me këshilltarët e Kukësit, që morën pjesë në protestë, të cilët në pamundësi për t'i shkarkuar, i përjashtoi nga Partia Socialiste", shprehet PD. Sipas saj, "derisa të bëjë

këtë akt të vërtetë distancimi, Partia Demokratike e konsideron Edi Ramën si urdhëruesin e dekorimit të atentatorit të Azem Hajdarit, për të cilin do të mbajë përgjegjësi personale". Vendimi i përfaqësuesve të Edi Ramës në Këshillin Bashkiak të Hasit u mor 4 ditë pasi Partia Demokratike i bëri thirrje kryetarit të Partisë Socialiste të Shqipërisë të ndalojë vendimmarrjen kriminale të këshilltarëve, të cilët janë plotësisht nën kontrollin e tij.

e ka propozuar dhe ka miratuar". Më tej, në njoftim thuhet se kryeministri i ka kërkuar prefektit të Kukësit refuzimin e firmosjes së atij vendimi, ndërkohë që sot në mbledhjen e grupit parlamentar e ka dënuar këtë shfaqje të shëmtuar papërgjegjshme

të këshilltarëve të Hasit, pavarësisht se në Këshillin Bashkiak të Hasit Partia Socialiste ka vetëm një këshilltar, i cili nuk ka votuar pro vendimit. "Duke i konsideruar akuzat vulgare të Partisë Demokratike, si një shpërdorim politik të radhës

së emrit e të kujtimit të Azem Hajdarit, kryeministri Edi Rama shpreh bindjen se ato s'janë asgjë tjetër veçse ana tjetër e medaljes së këtij episodi të politikës qorre e shurdhe të interesave më të ulëta", përfundon reagimi i kryeministrit Edi Rama.

SITUATA POLITIKE REAGIMET

"Numri i të dënuarve për krimin e organizuar mbetet i ulët"

Memo e qeverisë: Shqipëria e prekur nga terrorizmi, policia e prokuroria dështuan

Qeveria shqiptare krijon prokurorinë se është ende e ndikuar nga ndërhyrjet politike, duke bërë ende të pabesueshme për publikun. Edhe në luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, ekzekutivi shprehet se duhet të ketë më shumë bashkëpunim me institucionet e tjera, pasi rezultatet e deritanishme janë të dështuara. Në një Memo të publikuar nga "Ora News" theksohet se fenomeni i terrorizmit ka nevojë për një përqasje të përbashkët nga të gjitha institucionet për parandalimin. Qeveria shqiptare kërkon nga Prokuroria e Përgjithshme të intensifikojë luftën kundër krimin të organizuar dhe korrupsionit si dhe të garantojë pavarësinë së institucionit ligjzbatues. "Ekzistojnë raporte të vazhdueshme për ndërhyrjen politike në çështjet e

Memo e qeverisë

durave. Me qëllim përbushjen e prioritetit kyç të reformës në sistemin e drejtësisë, gjatë vitit të ardhshëm duhet të avancohet për implementimin e dispozitivave të reja kushtetuese dhe legjislativonit të ri të lidhur me to", thuhet në Memo. Qeveria thekson se prokuroria duhet të forcojë bashkëpunimin me institucionet e tjera ligjzbatuese në ndjekjen penale dhe ndëshkimin e korrupsionit me zero tolerancë. Gjithashtu, në Memo shfaqet hapur pakënaqësia me punën e prokurorisë në goditjen e krimin ekonomik. "Hetimet financiare nuk kryhen sistematikisht dhe numri i rasteve të konfiskimit të pasurisë në rastet e korrupsion-

it është i ulët. Kjo, pasi numri i asetëve të konfiskuara gjatë fazës fillestare është i ulët, duke sjellë për pasojë një numër të ulët asetesh të konfiskuara në kohën e dënimit përfundimtar", thuhet në dokument. "Policia dhe prokuroria kanë dështuar në zbulimin e grupeve të organizuara që fshihen pas kultivimit dhe trafikimit të lëndëve narkotike. Është e nevojshme të forcohet bashkëpunimi midis policisë dhe prokurorisë, me qëllim zbulimin efektiv të rrjeteve kriminale. Numri i të dënuarve për çështjet e krimin të organizuar mbetet i ulët. Shqipëria është prekur nga fenomeni i terrorizmit", thuhet në Memo.



Gjatë një seance parlamentare

Ambasadorja e BE mohan të ketë plan për një kamp refugjatësh nga ISIS në Tiranë

Darina Tanushi

Ambasadorja e Bashkimit Europian në Tiranë, Romana Vlahutin deklaroi dje, se nuk ka asnjë plan për ndërtimin e qendrave për emigrantë apo ish-luftëtarët e Shtetit Islamik në Shqipëri. E pyetur për këtë çështje në Berat, Vlahutin tha se debati është ngritur mbi një keqinterpretim sipas saj të deklaratës së kryeministrit bullgar, Bojko Borisov, në Tiranë. Mbështetëse e hapur e çeljes së negociatave për Shqipërinë, Vlahutin tha se vendi ka punuar, por tashtë vendimi është në dorën e 28 vendeve anëtare. "Jo, është tërësisht një keqinterpretim i asaj që ka thënë në atë konferencë për shtypin kryeministri bullgar. Unë kam qenë aty e pranishme dhe mund t'juaj siguroj që është absolutisht një jo", u shpreh Vlahutin, e pyetur nga gazetarët. Ideja sipas Vlahutin është ajo e një qendre studimore, për të cilën është folur prej kohësh, ku mund të diskutohet dhe studiohet fenomeni, tha Vlahutin, duke dhënë dy arsye përse Shqipëria mund të jetë vendi i duhur për këtë. "Ka dy arsye pse është diskutuar kjo ide për qendrën, sepse e para Shqipëria ka një model të mirë të harmonisë fetare, dhe arsyeja tjetër është se në Shqipëri është diskutuar prej kohësh lufta kundër ekstremizmit. Prandaj, është mirë ngritja e një qendre të tillë rajonale studimore për refugjatët që kthehen, në Shqipëri", u shpreh ambasadorja e BE-së, në Tiranë. Në lidhje me atë se a ka më vende skeptike që mund të mos votojnë në datën 28 e 29

Vlahutin: Arsyet pse është diskutuar për qendër emigrantësh në Shqipëri

Vendimi për negociatat? Do ta shohim në datën 28



Ambasadorja e Bashkimit Europian në Tiranë, Romana Vlahutin

KOMUNITETET FETARE

Në një letër të përbashkët drejtuar Kancelares gjermane Merkel dhe Presidentit francez Macron, të cilën ia dorëzuan sot ministrit Bushati, krerët e bashkësive fetare në Shqipëri bëjnë thirrje për një vendim pozitiv të tyre për hapjen e negociatave të anëtarësimit të Shqipërisë me BE. çeljen e negociatave me Shqipërinë, Vlahutin u shpreh se pret që vendimin e tyre ta shohë përkohërisht në datën 28 qershor. "Do ta shohim në datën 28 qershor ajo çfarë do vendosin vendet e BE. Di të them që Shqipëria ka punuar fort, por kjo do të varet nga vendimi i 28 vendeve anëtare. Komisioni bëri atë që duhet të bënte, tha atë që duhet të thoshte, pra dha rekomandimin e pakushtëzuar pra ajo që është e rëndë-

Pakti me Greqinë, Bushati: Kemi njoftuar Metën pas çdo negociate

Ministri për Evropën e Jashtme, Ditmir Bushati bëri të ditur dje, se këtë javë do të ketë një tjetër takim me homologun e tij grek, Nikos Kotzias. Ata do të vijojnë diskutimet për mundësinë e gjetjes së një marrëveshjeje sa i përket delimitimit të zonave detare. Në një prononcim për gazetarët nga Berat, Bushati tha: "paralelisht me takimin tonë, do të ketë dhe një takim tjetër të ekipit negociator. Ky është një proces që ka hyrë në një fazë, shpresoj të pakthyeshme, por që të dyja palët kanë nevojë për kohën e tyre, në mënyrë që të shkojnë drejt një marrëveshjeje të pranueshme, të drejtë dhe siç e kam theksuar, një marrëveshjeje e zbatueshme". Sipas tij,



thënë, e paketës që ne negociojmë e diskutojmë me palën greke, sepse paketa është shumë më e gjerë se kjo marrëveshje". Ai shtoi se vendimi i Gjykatës Kushtetuese për çështjen e detit është një udhërrëfyes si nuk duhet bërë një marrëveshje dhe cilat janë gabimet që duhen evituar kur futesh në një proces diskutimi. I pyetur nëse i ka dhënë presidentit të gjitha informacionet që i ka kërkuar, Bushati tha se "ka një komunikim institucional dhe njerëzor me Presidentin e Republikës për këtë çështje. Pas çdo rauti bisedimesh, Presidentit të Republikës i është vënë në dispozicion e gjithë problematika e çështjeve që janë diskutuar dhe hapave që janë hedhur në këtë proces".



Kryeministri ashpëron tonet me deputetët e PS: Shkoni pranë njerëzve

Edi Rama: Ka ulje të cilësisë së qeverisjes, zgjedhjet të vështira

Paralajmërimi për punësimet: Mos çoni "sms"

Kryeministri Edi Rama ashpëroi dje, tonet me deputetët e ministrat të grupit parlamentar socialist. Rama u kërkoi atyre të shkojnë pranë njerëzve dhe të mos ndërhyjnë për punësimet me "sms". Edhe pse ka gati një muaj e gjysmë që ka nisur llogaridhënia publike, kryeministri duket se nuk ka marrë rezultatin që priste prej të deleguarve të tij. "Njerëzit kanë halle, pse nuk jeni pranë tyre?", mësohet të jetë shprehur në mbledhjen me dyer të mbyllura të grupit parlamentar, kryeministri e njëherësh kryetari i PS-së, Edi Rama. Ai u ka kërkuar që të dëgjojnë me vëmendje çdo ankesë të qytetarëve. "Problemet që ngrihen nga njerëzit vijnë si pasojë e paafetësisë së drejtorëve tanë.

takim me përfaqësuesit e vendeve të huaja në Shqipëri, duke i ftuar të bëhen pjesë e programit "100 fshatrat". Kryeministri Edi Rama hodhi idenë e binjakëzimit të këtyre fshatrave me të tjerë

në Europë, duke thënë se kjo do të ishte një ndihmesë e madhe. Rama u shpreh se fshatarët duket ta kuptojnë që nuk janë vetëm. "Nëse do të bënim binjakëzime midis fshatrave me ata në vendet tu-

aja, të zhvillojmë modele për qasjet e përbashkëta midis zonave të ndryshme urbane, për të mbështetur edhe traditën. Iniciativa për partneritetin mund të jetë shumë e thjeshtë për secilin nga ju për të transformuar gjërat, që ndoshta ju po i bëni edhe në vendet tuaja. Ne duam t'i themi këtyre fshatarëve që nuk janë vetëm", tha Kryeministri. Më tej, Rama tha se këto do të jenë 100 fshatrat e parë që do të pësojnë transformim, por synimi është të shkohet edhe në fshatra të tjerë. "Të bëjmë të pamundurën të mundurën. Të ecim në një drejtim dhe në koordinim të plotë, në mënyrë të bëjmë maksimumin. Synimi është që në të krijojmë 100 pika të ndryshme graviteti në vende të ndryshme dhe fshatra që mund të jenë pas tyre, në mënyrë që të kemi potencial edhe për fshatrat e tjera", - u shpreh ai.



Përplasen PS-PD në Komisionin e Ligjeve, Alibeaj: Ç'bëhet me Agron Xhafajn?

Mbledhja e Komisionit parlamentar të Ligjeve përplasi dje, sërish opozitën me maxhorancën. Deputetët e PD-së kërkuan sërish largimin e ministrit të Brendshëm, Fatmir Xhafaj, duke e kthyer çdo diskutim në komisionet e Kuvendit në rend dite këtë çështje. Deputeti demokrat, Enkelejd Alibeaj tha se "shqiptarët duan të dinë se çfarë bëhet me Agron Xhafajn dhe pse nuk ikën Fatmir Xhafaj si ministër i Brendshëm". Në mbledhjen e djeshme të Komisionit të Ligjeve, e ftuar ka qenë ministrja e Drejtësisë, Etilda Gjonaj, për raportin vijtor të dikasterit që ajo drejton. Opozita kërkoi diskutim me ministrin për Xhafajn, por kërkesa e tyre u hodh poshtë nga kreu i Ligjeve, Ulsi Manja. Pas debatit, deputetët socialistë dhe ministrja e Drejtësisë, u larguan nga komisioni, duke lënë aty vetëm deputetët demokratë.

DEBATI TE KOMISIONI I LIGJEVE:

ENKELEJD ALIBEAJ: Pse ka ardhur ministrja kur nuk flet për Tahirin e Xhafajn? Për çfarë do flasë ministrja e Drejtësisë? Për koleksionin pranverë-verë të 'miu-misë?'
ULSI MANJA: Nuk kam ardhur të humbas kohë me ty, Enkelejd Alibeaj: Kush je ti që nuk humbet kohë... bujrum... ik mbajtja...
ULSI MANJA: Nuk jam nga ata burra që ia mbath... E kam shumë të lehtë unë. Ore mbyll mbledhjen unë, ik bëj konferencë shtypi ti pastaj, nuk kim nga ju ne.
ENKELEJD ALIBEAJ: Kjo historia e kapjes së drejtësisë, ka sjellë sot frytet e hidhura për gjithë shqiptarët, ku e ke Tahirin, ku e ke Xhafajn?
ULSI MANJA: Ty të ka marrë malli të dalësh në TV, por jemi për punë këtu.
PËRPARIM SPAHIU: Ulsi, ti ke hallin e ndeshjes...
ULSI MANJA: Do flisni, por tek selia e PD. Këtu ka rregullorë.
ENKELEJD ALIBEAJ: Nuk ka shans të më mbyllësh flajtën.
ULSI MANJA: Ore ti, lexon rregullorën e Salit, ç'të të them unë. Deri kur të vijë ndeshja do të flasësh në orën 2, aty e keni hallin ju, për ju Shqipëria është kampionat botëror.
ENKELEJD ALIBEAJ: Nëse ti i ke nxjerrë tapinë edhe komisionit, por nuk je ti pronari, të vjen hidhur ty, puna jote. Çfarë bëhet me Agron Xhafajn sot, kë të duan të dinë shqiptarët. Nuk je ti pronari këtu! Kemi nisur pelegrinazh...po e lini administratën pa punë...

Debati në Grupin e Partisë Demokratike për median

Salianji kundër Vokshit, pro financimit të TV private: RTSH-së t'i hiqen paratë publike

Kreu demokrat Lulzim Basha me mbledhjen e djeshme të grupit parlamentar deklaroi se qëndrimi i PD-së për projektligjin e propozuar nga qeveria për TVSH, do të jetë kundër faktit që me paratë publike të paguhen televizionet private. "Jemi kundër në mënyrë kategorike që taksat e qytetarëve të paguajnë televizionet", mësohet të jetë shprehur Basha. "Është skandaloze që paratë e taksave të qytetarëve të shkojnë për të blerë mediat qeveria", - tha deputetja Albana Vokshi. Ndërsa deputeti Salianji tha: "Në se tv private marrin para nga ligji dhe jo nga qeveria me VKM ose nëpërmjet lejeve apo favoreve të tjera, besoj se do jenë me pak të varura se sot".

DEBATI ME DYER TË MBYLLURA

LULZIM BASHA: Qëndrimet kryesore për këtë javë në komisione do të jenë Xhafaj, Tahir, Afera e Air Albania. Rama po tradhton Shqipërinë për Xhafajn dhe Tahirin, Rama ka ekzekutuar Gjykatën Kushtetuese. Diskutimi për Teatrin Kombëtar është një zhvatje e tokës publike dhe histori e pastër korupsioni ku kërkohet të marrin tokën për të përfutur miliona euro, qëndrimi për projektligjin e propozuar për TVsh ne jemi kundër që me paratë publike të paguhen private.
ALBANA VOKSHI: Është skandaloze që paratë e taksave të qytetarëve të shkojnë për të blerë mediat qeveria. Ervin Salianji: Kryetar, mendoj që kë të duhet ta diskutojmë dhe të dalim me qëndrim të plotë, televizioni publik është një shërbëtor i ndryrë i qeverisë. Televizioni publik shqiptar me taksat e qytetarëve ve nuk po i shërbën publikut, e nuk ka asnjë vlerë publike përveç shërbësës që i bën qeverisë dhe përveç korupsionit që bëjnë drejtuesit e televizionit nëpërmjet blerjes së gazetarëve apo nëpërmjet punësimeve duke e trajtuar si me privat se privatët. Ne duhet të dalim me propozim konkret, që ose mos paguhet asnjë taksë, sepse paratë e taksapaguesve nuk sjellin asnjë të mirë publike dhe nuk japin asnjë kontribut për publikun, ose të propozojmë me ligj që paratë e taksapaguesit t'i marrin tv private duke i kushtëzuar me disa hapësira të detyrueshme në shërbim të publikut. Në se tv private marrin para nga ligji dhe jo nga qeveria me VKM ose nëpërmjet lejeve apo favoreve të tjera, besoj se do jenë me pak të varura se sot. Me shume i shërbejnë shqiptarëve në se menaxhohen me cilësi dhe me kushte nga TV private se sa si televizion që e paguajnë shqiptarët për propaganda qeverie.
ALBANA VOKSHI: Duhet të jemi absolutisht kundër, kjo cenon pavarësinë e mediave dhe qeveria bë mediati.
LULZIM BASHA: Do ta diskutojmë kur ta kemi në rend dite, por ne jemi kundër në mënyrë kategorike që taksat e qytetarëve të paguajnë televizionet.

EPSA SHOQËRIA PËRMBARUESË PRIVATE "E.P.S.A" SHPK NJËTOFTON SHPALLJEN E ANKANDIT PËR:

1 - Trulli me sip. 100 m², ZVRPP Tirane, Zona Kadastrale: 8150, Numri i Pasurisë: 1/460, Vol. 42, Fq. 74, e ndodhur në Tirane. Kjo pasuri është e hipotekuar në favor të TIRANA BANK S.H.A. Çmimi me të cilin fillon ankandi është 5.375.520 LEKË. Ankandi do të zhvillohet në datë 28.06.2018, ora 16.00 në zyrën e shoqërisë "EPSA" shpk të ndodhur në Rr "Tsmali Qemali", Palli Fratari, K.6, Tirane.

2 - Trulli + Ndertese, me sip. 552 dhe ndertesë 206.5 m², ZVRPP Tirane, Zona Kadastrale: 8150, Numri i Pasurisë: 6/43, Vol. 20, Fq. 17, e ndodhur në Tirane. Kjo pasuri është e hipotekuar në favor të TIRANA BANK S.H.A. Çmimi me të cilin fillon ankandi është 952.000 EURO. Ankandi do të zhvillohet në datë 13.07.2018, ora 16.00 në zyrën e shoqërisë "EPSA" shpk të ndodhur në Rr "Tsmali Qemali", Palli Fratari, K.6, Tirane.

Per çdo informacion kontaktoni ne tel. 04 2262111 ose ne www.epsa.al

Shitje me Ankand të Dytë nga Studio Permbartore L.D.C

"Trulli" me sip. 1,874m² nga e cila 250m² është ndertesë, me Nr. Pasurisë 134/33, vol. 25, faqe 82, ZK 2436 e ndodhur në Levan, Fier. Regjistruar me Z. R. P. P. Fier në emrin e Shoq. Alibonj shpk. Çmimi fillestar për shitje është 6.180.854 Leke.

Data e shpalljes 15.05.2018
 Data e zhvillimit 20.06.2018 deri në orën 16.00

Ankandi zhvillohet në ambientet e Studios Permbartore L.D.C me adresë Rruga "Myslim Shyri" Vila 8/1, kati 1 Tirane.

Këshilli i Investimeve, ministri: Incentiva të reja fiskale për sektorët strategjikë

Ahmetaj: Investimet e huaja, këtë vit synojmë 1 miliard euro

"Investitorët shqiptarë, status të njëjtë me të huajt"

Qeveria do të nisë rishikimin e 4 ligjeve bazë, të cilat zhvillojnë sektorin e investimeve strategjike në Shqipëri. Ndryshimet do të reflektohen në ligjin e zonave të lira ekonomike, atë të Partneritetit Publik-Privat, ligjit të turizmit dhe atij të investimeve strategjike.

MBLEDHJA E KËSHILLIT

Gjatë një mbledhjeje jashtë radhe të Këshillit të Investimeve, ministri Arben Ahmetaj tha se synimi është që të ketë një barazi mes statusit të veçantë që marrin si investitorët e huaj dhe ata shqiptarë. Si i ftuar i veçantë në këtë takim, zv.presidenti i BERZH, Alain Pilloux tha se Shqipëria duhet të vazhdojë reformat në çështjet e pronësisë së tokës dhe të shërbimit të administratës publike. "Realizoni reformat, jeni në rrugën e duhur, por duhet të vazhdoni rritjen e shërbimeve publike që ofron administratë, çështjet e pronësisë. Vazhdoni punën dhe investimet në infrastrukturë dhe energji", - tha Pilloux. Ministri Ahmetaj tha se investimet e huaja direkte në 3 muajt e parë të vitit janë rritur me 60%, duke arritur një vlerë prej 284 milionë eurosh, ndërsa shumë kompani të huaja janë ofruar për të ardhur në Shqipëri e për të investuar një port jahtesh apo në prodhimin e pajisjeve teknologjike. "Viti 2017 u mbyll me investime të huaja në nivelin 907 milionë euro. Nëse i referohemi ecurisë së krahasueshmërisë së tremujorit të parë të këtij viti me tremujorin e parë të vitit 2017, atëherë besojmë që ky vit do të jetë sërish një rekord, me gati 1 miliard dollarë investime të huaja. Ecuria pozitive e investimeve të huaja direkte si dhe atyre vendëse reflekton trendin e ekonomisë shqiptare në 4-5 vitet e fundit", - tha ministri Ahmetaj. Sipas tij, në vitin 2017, për herë të parë punësimi në sektorin jobujqësor kaloi atë të sektorit bujqësor: "Shqipëria ka nivelin më të ulët historik të papunësisë 12.5%, ndërsa punësimi në tremujorin e parë të vitit 2018 ka një rritje prej 5% krahasuar me një vit më parë. Krahasuar me rajonin, jemi vendi me punësimin më të lartë të fuqisë punëtore të aftë për punë, 59.2% dhe papunësinë më të ulët tek të rinjtë, që vijon të zbrësë", - deklaroi ministri duke shtuar se është shfaqur interes i avancuar nga një kompani gjermano-zvicerane për ndërtimin e një porti jahtesh dhe mjetesh luksoze lundrimi. "Në turizëm, në Shqipëri aplikohet TVSH-ja e reduktuar 6%, për shërbimet e akomodimit dhe ushqimit brenda strukturave të hotelerisë. Në anën tjetër, po promovojmë agroturizmin. Sipërmarrjet e licencuara në sek-



Ministri Arben Ahmetaj

BE-BERZH, 100 mln euro për turizmin

Zëvendëspresidenti i BERZH-it deklaroi në Tiranë se nga ky fond do të përfitojnë edhe bizneset e vogla të turizmit. "Ne po përgatisim me qeverinë dhe Bashkimin Europian një program inovativ, i cili do të kombinojë paratë e BERZH dhe BE-së. Do të jetë një program i madh, rreth 100 milionë euro, për të ndërtuar rrugët lokale dhe ujësjellësit në zonat turistike. Por,

programi parashikon gjithashtu financime edhe për bizneset e vogla të turizmit, si dhe financon mbrojtjen dhe restaurimin e trashëgimisë kulturore dhe asaj natyrore", tha Alain Pilloux, zv.president i BERZH-it. Programi do të jetë një financim i përzierë, ku gjysma e parave janë kreditë të buta për qeverinë, ndërsa gjysma tjetër grante, pra para falas.

torin e agroturizmit do të përfitojnë ulje të tatimit-fitimit nga 15 në 5%. Pra, nuk ka rëndësi sa sipërmarrje e madhe do të jetë në agroturizëm, do të trajtohet me 5% tatimit-fitimit dhe normë të reduktuar

të Tatimit të Vlerës së Shtuar prej 6% për shërbimet e akomodimit dhe përjashtimi nga taksat e ndikimit në infrastrukturë të ndërtimeve të reja për qëllim agroturizmi", - deklaroi Ahmetaj.

Ministri e vuri theksin edhe te lehtësitë fiskale që ka ndërmarrë qeveria për bizneset. "Një lëvizje shumë e rëndësishme është rishikimi i tavanit të tatimit-fitimit, që praktikisht e ul me tri herë

ngarkesën fiskale për bizneset e prekura. Tatim-fitimi për bizneset me të ardhura deri në 14 milionë lekë ulët me tri herë, nga 15% në 5%. Me këtë masë, rreth 91%, që i bie afërsisht 95 mijë ndër-

marrje në Republikën e Shqipërisë, përfitojnë lehtësim të ngarkesës fiskale me tatimit-fitimin ose 0, ose 5%. Besoj që këtë të mërkurë e gjithë paketa kalon edhe në Këshillin e Ministrave", - tha ministri.

Legalizimet, qytetarët 3 vjet kohë për të paguar truallin

Qytetarët do të kenë mundësi të paguajnë faturat e truallit përmes bonove të privatizimit deri në vitin 2021. Duke qenë se ky proces është shtyrë për të disatë herë, Komisioni parlamentar për Ekonominë dhe Financat ka vendosur t'u lërë një afat 3-vjeçar qytetarëve, në mënyrë që të përmbyllin të gjithë procedurën me ALUIZNI-n. Propozimi është bërë nga deputeti socialist, Anastas Angjeli, ndërsa opozita nuk ka qenë prezentë në komision. I ftuar në komision, zv.ministri i Financave, Erion Luçi theksoi se 3 vjet janë të mjaftueshme për të përmbyllur këtë proces dhe në këtë mënyrë ulet fatura financiare për pronarët e truallit. Bonot e privatizimit janë emetuar fillimisht në vitin 1995. Familjet që kanë ndërtuar në tokë shtet apo tokë me pronarë, mund të paguajnë me bono privatizimi deri në 50 për qind të faturës, me qëllim marrjen e tapisë. Sipas të dhënave zyrtare të Ministrisë së Financave, në total janë emetuar 74.9 miliardë lekë bono privatizimi, prej të cilave janë shpërndarë publikut 51.2 miliardë lekë. Nga këto janë përdorur deri tani në proces privatizimi 10 miliardë lekë, ndërkohë që mbeten të shpërndara dhe të papërdorura 41 miliardë lekë të tjera. Gjatë tri viteve të fundit, në procesin e privatizimit të pronës shtetërore me të drejtën e parablesjes për ish-pronarët e truallit dhe për subjektet me kontratë enfitoze apo qiraje, rezultoi të jenë arkëtuar rreth 705 milionë lekë bono privatizimi.



Gubernuratori i Bankës së Shqipërisë, Gent Sejko, mori pjesë në samitin vjetor të vendeve të rajonit të mbajtur në Bećic, Mal i Zi. Në këtë samit, pjesëmarrës ishin përfaqësues të lartë të bankave qendrore të Malit të Zi, Maqedonisë, Bosnje-Hercegovinës, Kroacisë, Kosovës, Serbisë si dhe ministri të financave dhe drejtorët të tatimeve nga vendet e rajonit. Samiti i këtij viti, me temë "Stabiliteti financiar dhe monetar në rajon, 10 vjet pas krizës financiare globale" trajtoi zhvillimet më të fundit në ekonominë e rajonit. Paneli i guvernatorëve në të cilin, guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Gent Sejko ishte i ftuar të mbante një fjalë për të pranishmit, diskutoi rreth temës "Politika monetare dhe stabiliteti i sistemeve bankare në vendet e rajonit - Një dekadë pas falimentimit të Lehman Brothers". Në krye të fjalës së tij, guvernatori Sejko vlerësoi rëndësinë e pjesëmarrjes në aktivitetet të tilla, si një mundësi për të ndarë pikëpamjet e përvo-

Konferenca rajonale e guvernatorëve

Sejko: Kursi këmbimit, sfida aktuale e BSH-së



kat, si dhe për të shkëmbyer eksperiencat ndërmjet bankave qendrore. Në veçanti, ai theksoi se regjimi i kursit të lirë të këmbimit ka rritur fleksibilitetin tonë në përballimin e goditjeve dhe ka ndihmuar në reduktimin e kostove të tyre. Në vazhdim, guvernatori theksoi se edhe në regjime të lira të

kursit të këmbimit, politika monetare duhet të mbajë parasysh në mënyrë konsistente dhe koherente lëvizjet e kursit të këmbimit, për sa kohë dhe në masën që këto lëvizje ndikojnë ecurinë e inflacionit. "Luhatjet afatshkurtra të kursit të këmbimit janë normale në një regjim plotësisht të lirë të kursit. Reagimi i bankave qendrore duhet të varet nga ndikimi i tyre në inflacion, që në vetvete varet nga intensiteti dhe kohëzgjatja e kësaj luhatjeje. Sa më e madhe kohëzgjatja dhe sa më i lartë intensiteti i goditjeve, aq më i madh do të ishte ndikimi në inflacion, aq më i madh rreziku i ndryshimeve të shpejta në pritjet e inflacionit dhe aq më i lartë nevojia për reagim sistematik të politikës monetare", - tha guvernatori.

THEMELUESI I "LUARASIT" CEREMONIA



Gjatë ceremonisë së djeshme në Kolegjin Universitar "Luarasi"

Rektori Ethem Ruka: Institucioni elitare, ndër 4 më të rëndësishmit në vend

Prof. Aleks Luarasi dekorohet "Mjeshtër i Madh"

Presidenti Meta: Titull i merituar prej kohësh, pionier i arsimit

Voltiza Duro

Themeluesi i Kolegjit Universitar "Luarasi", prof. Aleks Luarasi është dekoruar ditën e djeshme nga presidenti i Republikës Ilir Meta me titullin "Mjeshtër i Madh". Kontributi i tij i çmuar shumëvjeçar për drejtësinë dhe sistemin arsimor në Shqipëri, është kurorëzuar në shenjë mirënjohjeje me këtë titull gjatë ceremonisë së mbajtur në ambientet e "Luarasit". Presidenti Meta në fjalën e tij, vlerësoi figurën e Aleks Luarasit si dhe theksoi se ky institucion i arsimit të lartë është tejet i rëndësishëm në vend. "Kam kënaqësinë dhe privilegjin që të vizitoj këtë institucion mjaft të rëndësishëm si dhe t'i akordoj profesor Aleks Luarasit titullin e merituar prej kohësh 'Mjeshtër i Madh'. Kemi ardhur në universitetin që ai krijoi për ta bërë më domethënës vlerësimin dhe për të ndarë edhe kënaqësi me personalitete të tjera dhe kolegë. Profesor Luarasi kuptohet edhe nga mbiemri që s'mund të ishte ndryshe për shkak të rrënjëve të forta patriotike dhe arsimsdashëse, të lara me gjak brez pas brezi. Kontributi i tij është mjaft i spikatur në fushën e jurisprudencës dhe mendimit bashkëkohor juridik dhe në shumë angazhime të tera në proceset demokratizuese të vendit. Profesi me urtësinë dhe vizonin e tij mbetet një nga pionierët e guximshëm



Presidenti Ilir Meta me profesor Aleks Luarasi



ILIR META INSTITUCION I RËNDËSISHËM

"Kam kënaqësinë dhe privilegjin që të vizitoj këtë institucion mjaft të rëndësishëm si dhe t'i akordoj profesor Aleks Luarasit titullin e merituar prej kohësh 'Mjeshtër i Madh', -tha Meta.



ALEKS LUARASI FALËNDERIMET

"Dëshiroj të falënderoj zotin Irfan Hysenbelliu, sepse atë krijesë që krijova unë, ai e mori, e zhvilloi dhe sot qëndron në ballë të universitetit, në sajë të akreditimit dhe punës", -u shpreh Aleks Luarasi



ETHEM RUKA "LUARASI", NDËR MË TË MIRËT

"Sot kemi një institucion të arsimit të lartë që është një nga katër shkollat e larta më të mira të vendit. Shpresojmë që vitin tjetër të hapim shkollën dokorale", - tha rektori i 'Luarasi'.

të modernizimit të arsimit shqiptar duke hedhur themelet e para me hapjen e Kolegjit Universitar Luarasi. Profesi kuptoi rëndësinë e investimit të vazhdueshëm duke e parë atë si një të mirë të vazhdueshme", -tha presidenti gjatë ceremonisë. Më tej ky i fundit u shpreh se profesor Luarasi u ka përcjellë të rinjve vlera dhe dije të paçmueshme. "Roli i profesor Aleks Luarasit si një nga ikonat e jurisprudencës shqiptare vlerësohet edhe në angazhimin e Shqipërisë në institucionet ndërkombëtare, sidomos si përfaqësues i Shqipërisë në Komisionin e Venecias. E kam të vështrë të përmbledh kontributin intelektual dhe akademik të jetës dhe veprës së Aleks Luarasit. Mbi gjithçka ajo që ne duhet të vlerësojmë është trashëgimia e paçmueshme e lirave dhe dijeve që profesori u ka përcjellë të rinjve. Sot rinia ka nevojë për modele frymëzimi për të ndërtuar të ardhmen. Profesor Luarasi e di më mirë se kushdo tjetër se suksesi në jetë nuk arrihet lehtë, por përmes përkushtimit. Dëshiroj të falënderoj të gjithë të ftuarit dhe miqtë e profesorit që na kanë nderuar në këtë ceremoni", -tha Meta.

CEREMONIA
Gjatë ceremonisë, themeluesi i Kolegjit Universitar Luarasi, Aleks Luarasi falënderoi Presidentin Ilir Meta; presidentin e Hysenbelliu Group, Irfan Hysenbelliu; rektorin Ethem Ruka, stafin akademik si edhe studentët. Ai u shpreh se Luarasi ka arritur një stad shumë të lartë dhe kjo është meritë e stafit akademik dhe gjithë bashkëpunëtorëve.

"Dëshiroj të falënderoj për këtë vlerësim përmblyllës të jetës sime të gjatë në radhë të parë Presidentin e Republikës Ilir Meta, goftë për dekorimin, goftë për motivacionin dhe goftë për vlerësimin e lartë të veprimitarisë sime. Dëshiroj të falënderoj zotin Irfan Hysenbelliu, presidentin e grupit me të njëjtin emër, sepse atë krijesë që krijova unë, ai e mori, e zgjeroi më tej, e zhvilloi më tej dhe sot qëndron në ballë të universitetit, në sajë të besimit, të akreditimit dhe punës së gjithanshme. Dëshiroj të vlerësoj stafin e Universitetit Luarasi, në mënyrë të veçantë rektorin Ethem Ruka për mbarëvajtjen e kësaj shkolle. Shkolla ka arritur një stad shumë të lartë dhe kjo është meritë e stafit akademik dhe gjithë bashkëpunëtorëve", deklaroi profesor Aleks Luarasi. Ndërkohe gjatë fjalës së tij, rektori i Universitetin 'Luarasi' Ethem Ruka tha se Universiteti 'Luarasi' është rritur dita ditës dhe sot është një nga 4 institucionet e arsimit më të mira në Shqipëri. "Sot kemi një institucion të arsimit të lartë që është një nga katër shkollat e larta më të mira të vendit. Shpresojmë që vitin tjetër të hapim shkollën dokorale. Është kënaqësi që ju kemi mes nesh, sepse sot ne dekorojmë Aleks Luarasin, i cili është një burrë i urtë dhe i mençur. Ai është kryetar i bordit 'Luarasi'. Falënderoj dhe presidentin e 'Hysenbelliu Group' që e ka parë këtë institucion si institucion që mbarat vlera" -tha rektori i 'Luarasi'.

FSDKSH: Kush ka të drejtë të marrë falas barnat e listës me rimbursim

Sigurimi shëndetësor, zbardhen përfitimet e pensionistëve

Kategoritë e tjera që përfshihen në skemë

Voltiza Duro

Të gjithë shtetasit që paguajnë kontributet për sigurimet shëndetësore, kanë të drejtën e përfitimit të shërbimeve mjekësore falas si dhe rimbursim të barnave. 'Gazeta Shqiptare' zbardh sot përfitimet që mund të kenë pensionistët, invalidët e plotë apo dhe kategori të tjera individësh falë sigurimit shëndetësor. "Masa e kontributit të sigurimit të detyruar shëndetësor është 3,4% e bazës për llogaritjen e kontributeve. Për të punësuarit, kontributet paguhen, në masën 50 % (pesëdhjetë për qind) nga punëdhënësi dhe në masën 50 % (pesëdhjetë për qind) nga i punësuar. Si bazë për llogaritjen e kontributit shërben paga bruto e personit të siguruar", thekson Fondi i Sigurimit të Detyruar të Kujdesit Shëndetësor. Ky i fundit më tej bën me dije se kontributi i shtetit për personat ekonomikisht joaktivë bazohet në konsumin për frymë të shërbimit shëndetësor, indeksuar me koeficientin e inflacionit.

KATEGORITË

Çdo shtetas që paguan kontribut për sigurim shëndetësor, ose për të cilin paguan shteti, është i siguruar dhe përfiton nga skema e sigurimeve shëndetësore. Karta e Shëndetit është dokumenti i vetëm që vërteton se personi është i siguruar në skemën e sigurimeve shëndetësore. Sigurimi i detyrueshëm shëndetësor dhe pagesa e kontributeve përkatëse janë të detyrueshme për të gjithë personat ekonomikisht aktivë, me banim të përhershëm në Shqipëri, si të punësuarit; personat e vetëpunësuar; punonjësit e papaguar të familjes; apo dhe persona të tjerë ekonomikisht aktivë. Sigurimi i detyrueshëm shëndetësor mbulon, gjithashtu, kategoritë e personave ekonomikisht joaktivë, pagesa e kontributeve të të cilëve financohet nga Buxheti i Shtetit ose burime të tjera të përcaktuara me ligj. Në këtë kategori përfituesish bëjnë pjesë: personat që përfitojnë nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore; personat që përfitojnë ndihmë

BARNAT ME RIMBURSIM

"Më konkretisht për barnat, personat e siguruar, ose nuk paguajnë fare ose kanë një pagesë të pjesshme që shkon deri në 50 % të çmimit të barnave, por jo më shumë. Kategoritë si: pensionistë, invalidë të plotë, fëmijë 0 - 12 muaj, të sëmurë me CA, TBC, të verbër përfitojnë falas alternativën e parë të çdo bari të përfshirë në listë", nënvizon FSDKSH.

ÇFARË PËRFITOHET?

- Vizitat mjekësore pa pagesë në institucionet shëndetësore publike, që financohen nga sigurimi shëndetësor dhe në respektim të sistemit të referimit;
- Vizitën falas në banesë - kur gjendja shëndetësore e të sëmurit nuk mundëson paraqitjen në institucionin shëndetësor;
- Ekzaminimet mjekësore në institucionet shëndetësore publike;
- Trajtimet mjekësore pa pagesë në spitalet publike;
- Shërbimet e paketave shëndetësore në institucionet shëndetësore private të kontraktuara me Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor;
- Rimbursimi i plotë ose i pjesshëm i barnave të Listës së Barnave të Rimbursueshme në varësi të kategorisë;
- Më konkretisht për barnat, personat e siguruar, ose nuk paguajnë fare ose kanë një pagesë të pjesshme që shkon deri në 50 % (për qind) të çmimit të barnave, por jo më shumë.
- Kategoritë si: pensionistë, invalidë të plotë, fëmijë 0 - 12 muaj, të sëmurë me CA, TBC, të verbër përfitojnë falas alternativën e parë të çdo bari të përfshirë në listë.
- Kategoritë si: veteran dhe invalidë të luftës, përfitojnë falas në masën 100 % të gjitha barnat e listës së rimbursueshme, si dhe të gjitha barnat e tjera të regjistruara në Republikën e Shqipërisë.

ekonomike ose pagesën për aftësinë e kufizuar, në përputhje me legjislacionin për-

katës; personat e regjistruar si të papunë - punëkërkuar në Shërbimin Kombëtar të Punë-

simi; shtetasit e huaj azilkërkues në Republikën e Shqipërisë; fëmijët nën moshën 18 vjeç; nxënësit e studentët nën moshën 25 vjeç, me kusht që të mos kenë të ardhura nga veprimtari ekonomike; kategori personash që përcaktohen me ligje të veçanta; viktimat e trafikimit, sipas identifikimit të bërë nga strukturat e Ministrisë të Punëve të Brendshme si dhe personat e siguruar vullnetarisht.

PËRFITIMET

Sigurimi i detyrueshëm financon paketat e shërbimeve të sigurimit të detyrueshëm, ku përfshihen: vizitat mjekësore pa pagesë në institucionet shëndetësore publike; vizitën falas në banesë kur gjendja shëndetësore e të sëmurit nuk mundëson paraqitjen në institucionin shëndetësor; ekzaminimet mjekësore në institucionet shëndetësore publike; si dhe trajtimet mjekësore pa pagesë në spitalet publike. Gjithashtu, sigurimi i detyrueshëm mundëson edhe shërbimet e paketave shëndetësore në institucionet shëndetësore private të kontraktuara me Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor; rimbursim të plotë ose të pjesshëm të barnave të Listës së Barnave të Rimbursueshme në varësi të kategorisë. "Më konkretisht për barnat, personat e siguruar, ose nuk paguajnë fare ose



PËRFITUESIT

Persona ekonomikisht aktivë:

- të punësuarit;
- personat e vetëpunësuar;
- punonjësit e papaguar të familjes;
- persona të tjerë ekonomikisht aktivë.

Personat ekonomikisht joaktivë:

- personat që përfitojnë nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore;
- personat që përfitojnë ndihmë ekonomike ose pagesën për aftësinë e kufizuar, në përputhje me legjislacionin përkatës;
- personat e regjistruar si të papunë - punëkërkuar në Shërbimin Kombëtar të Punësimit;
- shtetasit e huaj azilkërkues në Republikën e Shqipërisë;
- fëmijët nën moshën 18 vjeç;
- nxënësit e studentët nën moshën 25 vjeç, me kusht që të mos kenë të ardhura nga veprimtari ekonomike;
- kategori personash që përcaktohen me ligje të veçanta;
- viktimat e trafikimit, sipas identifikimit të bërë nga strukturat e Ministrisë të Punëve të Brendshme.
- Personat e siguruar vullnetarisht

kanë një pagesë të pjesshme që shkon deri në 50 % të çmimit të barnave, por jo më shumë. Kategoritë si: pensionistë, invalidë të plotë, fëmijë 0 - 12 muaj, të sëmurë me CA, TBC, të verbër përfitojnë falas alternativën e parë të çdo bari të përfshirë në listë. Kategoritë si: veteran dhe invalidë të luftës, përfitojnë falas në masën 100 % të gjitha barnat e listës së rimbursueshme, si dhe të gjitha barnat e tjera të regjistruara në Republikën e Shqipërisë", nënvizon FSDK-

SH. Pra, nëse jeni pensionistë, invalidë, veteranë, të punësuar, të vetëpunësuar, të siguruar vullnetarisht, fëmijë, gra shtatzëna, persona që trajtohen me ndihmë ekonomike, punëkërkuar etj, me anë të kartës së shëndetit mund të përfitoni nga skema e sigurimeve shëndetësore, duke filluar nga recetat e rimbursueshme, shërbimi të mjeku i familjes, të mjeku specialist, në qendrat spitalore, pra në të gjithë sistemin tonë shëndetësor publik.

BE e PNUD mbështesin me fonde çerdhe për fëmijët e gratë romë në Berat

Vlahutin e Williams: Përfshirja e grave në sektorin privat ul varfërinë

Brian Williams, Koordinator i Përhershëm i OKB-së në Shqipëri dhe Përfaqësues i Përhershëm i UNDP tha dje, se 40 sipërmarrje në të gjithë vendin janë mbështetur nga Bashkimi Evropian, UNDP dhe qeveria. Gjatë një aktiviteti në Berat, ku u përfundua çerdhja e re nr.7 e rikonstruktuar nga këto fonde dhe në kuadër të projektit "Fuqizimi Ekonomik dhe Social i romëve dhe egjiptianëve, shtesë për përfshirjen sociale" të PNUD, Brian Williams u shpreh se kjo çerdhë do të mirëpresë 60

fëmijë nga të cilët 20 fëmijë të komunitetit rom dhe egjiptian. Në ceremoninë e përmirimit ishin të pranishëm Ogerta Manastirliu, ministere e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale, Ditmir Bushati, ministër për Europën dhe Punët e Jashtme, Romana Vlahutin, ambasadore e Delegacionit të BE-së në Shqipëri, deputetë, përfaqësues të PNUD-it, përfaqësues të institucioneve vendore, prindër të fëmijëve, etj. "Krijimi i mundësive për përfshirjen e fëmijëve romë dhe egjiptianë sa më herët në ciklin e edukimit është mënyra më e mirë për inte-

grimin e komunitetit rom dhe egjiptian", - tha Manastirliu në fjalën e hapjes. Ndërkohë, po në Berat BE e PNUD kanë mbështetur me grante edhe gra të komunitetit rom. Emanuela është një prej tyre. Ajo ka hapur një rrobagepësi në tregun e qytetit. Gjatë vizitës në atelienë e Emanuelës, ambasadorja e BE-së, Romana Vlahutin tha: "Është privilegj të ndihmohet një grua për jetesën e familjes, dhe të ndihmojë në rritjen e fëmijës. Kudo që shkoj në Shqipëri takoj njerëz që punojnë fort për familjen e tyre dhe përqipimi si të gje-



jmë zgjidhjen më praktike për t'i ndihmuar në këtë drejtim. Për mua gratë shqiptare janë një forcë shqiptare dhe kam kënaqësi që ndihmoj gratë e tjera". Ndërsa Koordinatori i Përhershëm i OKB-së në Shqipëri dhe Përfaqësues i Përhershëm i PNUD, Brian

Williams tha se "e rëndësishme është që gratë të përfshihen sa më shumë në sektorin privat, sepse ul varfërinë dhe nxjerr nga sektori informal ku mbajnë vetëm frymë gjallë dhe i ndihmon për të mbajtur familjet e tyre me këto biznese të vogla".



Pamje nga grabitjet e kasafortave



2018-02-24 03:27



Sekuestrohen makina, armë, drogë. Ja çfarë i tradhtoi anëtarët e grupit kriminal

Goditet banda e grabitësve të kasafortave, në pranga 5 persona mes tyre një ish-police

"Skifterët", autorë të 11 vjedhjeve të bizneseve dhe bankave në 6 qytete

Ina Allkanjari

Gjatë orëve të para të mëngjesit të djeshëm policia e Tiranës ka goditur një grup të strukturuar kriminal, duke vënë në pranga pesë persona, mes tyre një ish-oficer policie. Konkretisht anëtarët e këtij grupi nën kërcënimin e armëve vidhnin kasaforta në biznese të ndryshme jo vetëm në Tiranë, por edhe në qytete të tjera të Shqipërisë. Arrestimi i tyre u bë i mundur teksa po tentonin të grabisnin kasafortën e një biznesi të madh në kryeqytet. "Pas një pune disa mujore me metoda speciale hetimi, Sektori i Krimeve të Rënda ndaj Jetës dhe Pronës në D.V.P.Tiranë në bashkëpunim me Komisarariatet e Policisë Tiranë dhe nën drejtimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë finalizoi operacionin policor të koduar "Kasaforta", si rezultat i të cilit u bë kapja dhe arrestimi në flagrancë i shtetasve Saimir Kuçi, 35 vjeç, banues në Tiranë, i dënuar më parë për vjedhje me armë; Elton Lika, 35 vjeç, banues në Tiranë, i dënuar më parë për vjedhje me armë; Valmend Pelivani, 27 vjeç, banues në Tiranë, dënuar më parë për vjedhje; Donald Ahmetaj, 28 vjeç, banues në Tiranë, i dënuar më parë për vjedhje; Engrid Hënaj, 31 vjeç, banues në Tiranë, i dënuar më parë për vjedhje", thuhet në njoftimin e policisë. Një ndër anëtarët e grupit, shtetasi Engrid Hënaj ka qenë ish-oficer policie i arrestuar më parë, pasi komunikonte me një person të shpallur në kërkim për vjedhjen e një makine. Grupi që guante kryesisht kasafortat e bizneseve u pikas nga policia pas kryerjes së një grabitje



Ish-efektivi i policisë, Engrid Hënaj



27-vjeçari, Valmend Pelivani

Anëtar i bandës së grabitësve, e kaluara e errët e Valmend Pelivanit, i njohur si rivali i Shullazit

Një ndër personat e arrestuar ditën e djeshme, si anëtar i grupit të grabitësve është një emër i njohur për policinë. Bëhet fjalë për Valmend Pelivani, i njohur ndryshe si Gjon Pelivani. Kujtojmë ngjarjen e ndodhur mesditën e 16 shkurtit, rreth orës 12:30, në rrugën "Irfan Tomini", ku gjatë një konflikti të castit u plagosën me armë zjarri në këmbë shtetasit Renato Hoxha, 31 vjeç dhe Gjon Pelivani 27 vjeç. Në atë kohë policia u vu në kërkim të Florian Musait dhe djali të tij, Arti Musai, i cili dyshohej si autori i plagosjes. Paraprakisht u tha se personat janë përfshirë në një sherr brenda një lokali, e më pas kanë dal jashtë ambienteve të lokalit ku janë konfliktuar deri në përdorimin e armëve. Gjon Pelivani ishte konfliktuar



me pronarin e lokalit Florian Musain. Në sherr e sipër është afruar edhe djali i Florian Musait, Arti Musai. Ky i fundit ka qëlluar drejt Gjon Pelivanit disa herë, duke elënë të plagosur. Nga të shtënat ka mbetur i plagosur aksidentalisht edhe kamerieri i lokalit. Ndërkohë në shënjestër të shtënave ishte Gjon Pelivani. Policia dyshon se shkak i ngjarjes së rëndë mund të

jetë një konflikt i castit por nuk përjashtohet pista e konflikteve të vjetra të Pelivanit. Nga verifikimet e kryera, i riu rezultoi person me precedent të penal. 27-vjeçari ka qenë i dënuar më parë për vjedhje. Ndërsa në vitin 2015, Pelivani, atëherë 24-vjeç, është plagosur me armë zjarri nga Gilmando Dani, shok i Emiljano Shullazit. Pelivani ka pasur konflikte me grupin e Shullazit, të cilat kanë arritur deri në përdorimin e armëve të zjarrit. Nuk dihet nëse ngjarja ka lidhje me të shkuarën e tij të errët. Gjithashtu, Valmend Pelivani është hetuar dhe për plagosjen e policit Ermal Bregu, ngjarje kjo e ndodhur te ish-Parku i autobusëve në dhjetor 2017. Edhe pse është marrë në pyetje, Pelivani është lënë i lirë për mungesë in.AL.

në territorin e komisarariatit nr:2 në kryeqytet. Roja i biznesit, i cili u grabit, lajmëroi policinë dhe dha

përshkrime mbi autorët si dhe mjetin me të cilin lëviznin dhe më pas u bë i mundur neutralizimi i tyre në

rreth-rrrotullimin e Saukut nga agjentët e krimin të pranë komisarariatit nr. 1. Burimet policore konfirmojnë se filli-

TË ARRESTUARIT

- Saimir Kuçi, 35 vjeç, banues në Tiranë, i dënuar më parë për vjedhje me armë.
- Elton Lika, 35 vjeç, banues në Tiranë, i dënuar më parë për vjedhje me armë.
- Valmend Pelivani, 27 vjeç, banues në Tiranë, dënuar më parë për vjedhje.
- Donald Ahmetaj, 28 vjeç, banues në Tiranë i dënuar më parë për vjedhje.
- Engrid Hënaj, 31 vjeç, banues në Tiranë, i dënuar më parë për vjedhje.

GRABITJET

- Në datë 02.03.2018 ku është vjedhur me armë filliali bankës Credins në rrugën dytësore Tiranë- Durrës.
- Në datë 12.04.2018 ku në Kamzë Tiranë është vjedhur banesa e shtetasit A.Rr.
- Në datë 15.06.2018 ku në fshatin Vaqar është vjedhur kasaforta e një mobilierie.
- Në datë 18.06.2018 ku tek ish qyteti nxënësve në Tiranë është tentuar të vidhet me armë një mobilieri.
- Në datë 09.10.2017 ku në qytetin e Kavajës është vjedhur e kasaforta e një firme.
- Në datë 06.01.2018 ku është vjedhur kasaforta e një shoqërie në rrugën "Frederik Shiroka".
- Në datë 23.12.2017 ku është vjedhur kasaforta e një dyqani në rrugën "Njazi Meka".
- Në datë 04.06.2018 ku është vjedhur kasaforta e një supermarketi në rrugën "Hysen Xhura".
- Në datë 26.02.2018 ku është vjedhur kasaforta e një supermarketi në rrugën "Tom Plezha".
- Në datë 30.01.2017 ku është vjedhur kasaforta e një firme sheqeri në fshatin Picar bashkia Vorë.
- në datë 06.04.2017 ku është vjedhur kasaforta e një firme në fshatin Ahmetaq bashkia Vorë.

miht anëtarët e grupit kanë bërë rezistencë, por janë neutralizuar në kohë nga policia.

GRABITJET

Nga hetimet rezultojnë se ky grup i strukturuar kriminal, në periudha të ndryshme kohore ka vjedhur me armë kasaforta me vlera monetare të bizneseve të ndryshme, jo vetëm në juridiksionin e Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, por dhe në qytete të tjera të Shqipërisë.

Për realizimin e këtyre ngjarjeve, këta shtetas lëviznin orët e vona të natës të armatosur, përdornin autonetje të vjedhura dhe të marra me qira duke u ndihmuar dhe nga persona të tjerë. Nga puna hetimore është bërë i mundur dokumentimi ligjor i disa ngjarjeve të ndodhura në kryeqytet, por dhe në qytete të tjera si Durrës, Kavajë, Laç, Lezhë dhe Berat, konkretisht i 11 ngjarjeve: në datë 02.03.2018 ku është vjedhur me armë filliali bankës Credins në rrugën dytësore Tiranë- Durrës, në datë 12.04.2018 ku në Kamzë Tiranë është vjedhur banesa e shtetasit A.Rr; në datë 15.06.2018 ku në fshatin Vaqar është vjedhur kasaforta e një mobilierie; në datë 18.06.2018 ku tek ish-qyteti nxënësve në Tiranë është tentuar të vidhet me armë një mobilieri; në datë 09.10.2017 ku në qytetin e Kavajës është vjedhur e kasaforta e një firme; në datë 06.01.2018 ku është vjedhur kasaforta e një shoqërie në rrugën "Frederik Shiroka"; në datë 23.12.2017

ku është vjedhur kasaforta e një dyqani në rrugën "Njazi Meka"; në datë 04.06.2018 ku është vjedhur kasaforta e një supermarketi në rrugën "Hysen Xhura"; në datë 26.02.2018 ku është vjedhur kasaforta e një supermarketi në rrugën "Tom Plezha"; në datë 30.01.2017 ku është vjedhur kasaforta e një firme sheqeri në fshatin Picar bashkia Vorë; në datë 06.04.2017 ku është vjedhur kasaforta e një firme në fshatin Ahmetaq bashkia Vorë. Në cilësinë e provës materiale gjatë hetimit të këtyre ngjarjeve janë sekuestruar 3 autonetje, 2 armë zjarri, 4 maska, 6 palë doreza pune, 1 palë pranga metalike si ato të policisë, 1 portofol me stemën e policisë, 1 sasi lënde e dyshuar narkotike e llojit heroïne, 1 cantë me vegla pune si pinca, kaçavida, 1 gur fresibël që shërben për prerjen e hekurave, veshje të ndryshme, pajisje speciale për hapjen e dverve të blinduara, 1 vare dhe 6 lëva hekuri. Sakaq policia po vijon punën intensive për dokumentimin e plotë ligjor të këtyre ngjarjeve. Materialet do t'i kalojnë për ndjekje të mëtejshme Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës Parë Tiranë, për veprat penale të "Vjedhjes së bankave dhe arkave të kursimit e kryer në bashkëpunim", "Vjedhjes me armë", "Prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve luftarakë e municionit", "Prodhim dhe shitja e lendeve narkotikeve", "Mbajtje pa të drejtë e uniformës" dhe "Kanosjes për shkak të detyrës".

SHKODËR - Gjykata e Shkallës së Parë në Shkodër dje ka vendosur masën e sigurisë "Arrest me burg" për 6 personat që u arrestuan mesnatën e së premtes gjatë operacionit të koduar "West Univers" me 200 kg marijuanë. Bëhet fjalë për shtetasit: Ardit Haxhagaçi, 34 vjeç nga Shkodra; Fatbardh Gostini, 37 vjeç nga Lezha; Neritan Saraçi, 51 vjeç nga Shkodra; Rezart Çarçani, 34 vjeç nga Shkodra; Ramadan Dushaj 61 vjeç nga Malësia e Madhe dhe Vilson Noka, 27 vjeç nga Lezha. Gjatë seancës gjyqësore, 6 të pandehurit kanë mohuar të kenë lidhje me sasinë prej 200 kg lëndë narkotike. Ata janë shprehur në sallën e gjyqit se nuk

'Koka' e grupit kriminal: S'kam lidhje me drogën, rashë në grackë

U arrestuan duke shkëmbyer 200 kg marijuanë, gjykata lë në burg 6 personat e arrestuar

OPERACIONI ANTIDROGË

Sipas bluve, rreth orës 23:54 të së premtes që shkoi, pranë vendit të quajtur kompleksi "Univers" në aksin Lezhë-Milot, shtetasit e arrestuar ishin bërë gati që të shkëmbejnë sasinë prej 200 kg marijuanë. Në atë moment ka ndërhyrë policia. Të arrestuarit duke tentuar të shmangin kanë goditur me mjetet e tyre makinat e policisë, veprim ky që ka vënë në rrezik jetën e efektivëve të pranishëm në vendngjarje.

kanë qenë duke shkuar në drejtim të Laçit për të bërë pazare droge. 61-vjeçari Ramadan Dushaj, i dyshuari

kryesor në këtë grup të strukturuar kriminal (sipas policisë) deklaroi në gjykatë se aktiviteti i tij janë prodhimet

bujqësore. Dushaj tha se ka rënë në grackën e policisë, sepse kishte shkuar për t'u marrë vesh për tregtimin e produkteve bujqësore, me të cilat ai merret dhe jo për drogë siç akuzohet. Sipas 61-vjeçarit, ai ka rënë në grackën e një personit të infiltruar nga policia. Edhe 5 të arrestuarit e tjerë kanë mohuar të kenë lidhje me sasinë e marijuanës që u sekuestrua pak ditë më parë. Ata janë shprehur se s'kanë patur fare dije



Gjykata e Shkodrës

ni për sasinë e drogës dhe se aty mund të bëhej një pazar i tillë siç dyshon policia dhe prokuroria. Prokurorja Ajola Prençi kërkoi vendosjen e masës së sigurisë "Arrest me burg", ndërsa avokatët mbrojtës kërkuan shpalljen të pavlefshëm të arrestimit, pasi sipas tyre mungon akti i

ekspertizës së lëndës së gjetur, ndërsa përgjimet nuk janë të mjaftueshme për t'i mbajtur në burg. Në fund të seancës, gjyqtari Hasan Selimi vendosi lëniën në qeli të shtetasve të mësipërm, të cilët akuzohen se janë pjesë e një grupi të strukturuar kriminal të trafikut të drogës.

Familjarët e 60-vjeçarit në polici: Nuk kemi konflikte me askënd

Shkodër, vritet me plumb në kokë pronari i servisit të makinave

Mehdi Kavaja u gjet i pajetë nga fqinji i tij

Senad Nikshiqi

SHKODËR

Një 60-vjeçar nga Shkodra është gjetur i vdekur në servis të makinave në pronësi të tij, ndërsa dyshohet se është vrarë me plumb në kokë. Bëhet fjalë për Mehdi Kavajën, i cili bënte riparime dorezash të automjeteve. Fillimisht u mendua se vdekja e Kavajës ka qenë për shkak natyral (se ka pasur hemorragji në kokë), por pas hetimit të kryer nga ana e policisë dhe ekspertizës mjeko-ligjore rezultoi se vdekja ka ardhur si shkak i dhunës së ushtruar ndaj tij. Pas ngjarjes së ndodhur pasditën e djeshme në lagjen "Tophanë" (ose "Salo Halili"), policia e qytetit verior ka nisur hetimet. Sipas bluve gjatë këqyrjes së trupit të pajetë është konstatuar një vrimë në kokën e 60-vjeçarit dhe pas autopsisë është gjetur edhe një trup i huaj që dyshohet se është një plumb që më pas i ka marrë jetën. "Më datë 18.06.2018, në ora 15:30, jemi njoftuar se në lagjen Salo Halili, Shkodër, në servis të tij për automjete, është gjetur i vdekur shtetasi M.K. 60 vjeç, banues i lagjes "Salo Halili". Nga veprimet e para hetimore, ka rezultuar se viktima ka një vrimë në kokë, por pritet akti i plotë i ekspertizës mjeko-ligjore për përcaktimin e llojit të dëmtimit. Në vendngjarje po kryhen të gjitha veprimet hetimore për zbardhjen e plotë të rrethanave të ngjarjes nëse kemi të bëjmë me vrasje apo ngjarje aksidentale", thuhet në njoftimin zyrtar të policisë së Shkodrës. Ka qenë një kalimtar i rastit që ka parë të shtrirë në tokë shtetasin Mehdi Kavaja pranë servisit të tij në afërsi të xhamisë së



60-vjeçari Mehdi Kavaja



Vendi ku ndodhi njarja

Tophanës. Menjëherë fqinji ka njoftuar ambulancën, e cila ka bërë edhe transportimin e 60-vjeçarit në spitalin rajonal të Shkodrës. Edhe mjekët fillimisht menduan se vdekja e pronarit të servisit të makinave ka ardhur nga shkaqe natyrale, por pas ekspertizës u konstatua se 60-vjeçari kishte një vrimë në kokë dhe dyshohet se dikush e ka qëlluar atë me plumb. Mehdi Kavaja kishte vite që punonte në servis të tij në lagjen "Tophanë" ku merrej me riparimin e dorezave të automjeteve. Burime pranë familjarëve bëjnë me dije se 60-vjeçari nuk kishte konflikte me askënd. Ende nuk ka një pistë rreth shkaqeve të kësaj ngjarje, ndërsa mbeten mister rrethanat. Policia vendore e Shkodrës po heton intensivisht për zbardhjen e plotë të rrethanave të kësaj ngjarjeje.



REPUBLICA E SHQIPERISE
"PRODHIME KARBONIKE" SH.A.
(Carbon Plant Imp.&Exp. Co)

Adresa :
Zona Industriale Bradashesh
Elbasan EL 3000
Teli : +355 54 255 562
Teli Fax : +355 583 226 244
E-mail : info@carbonplant.com
web: www.carbonplant.com
Kapitali 217.592.150 lëko
NIPT J62903303 L / Kodi Fiskal 802528

NJOFTIM

Bazuar ne Ligjin nr.9901 date 14.04.2008, njoftojme mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme te Shoqerise me kete rend dite:

1. Miratimi i pasqyrave financiare te vitit ushtrimor 2017 dhe i rezultatit financiar.
2. Miratimi i Programit te zhvillimit per vitin 2018.
3. Emerimi i ekspertit kontabel te regjistruar per auditimin e pasqyrave financiare te vitit ushtrimor 2018.
4. Te tjera:
- a) Rinovimi dhe miratimi i ODT.
5. Miratimi i projekt rezolutave te ndryshme.

Mbledhja do te behet ne ambientet e selise se shoqerise me date **09 Korrik 2018, ora 11.30**

Dokumentat e nevojshme per mbledhjen e asamblese jane vene ne dispozicion ne seline e shoqerise.

Adresa jone eshte :
Prodhime Karbonike sha, (Zona Industriale),
Elbasan, Albania
Tel & Fax: +355 542 55 562
Fax : +355 583 26 244
E-mail: info@carbonplant.com

DREJTORI I PERGJITHSHEM
BASHKIM PROGRI

AUTOPSIA
Burime zyrtare nga policia e Shkodrës bënë me dije se gjatë këqyrjes së trupit të pajetë është konstatuar një vrimë në kokën e 60-vjeçarit dhe se, pas autopsisë, është gjetur edhe një trup i huaj që dyshohet se është një plumb që më pas i ka marrë jetën.

Protestë pa leje kundër Ramës, nën hetim deputeti i PD-së me të birin dhe 24 qytetarë
DIBËR - Policia e Dibërës ka nisur hetimet ndaj një grupi qytetarësh të Peshkopisë që protestuan ditën e diel në Peshkopi gjatë aktivitetit të kryeministrit Edi Rama. Sipas të dhënave zyrtare, janë 26 persona ndaj të cilëve ka nisur procedimi penal, mes tyre deputeti i PD-së Xhemal Gjunkshi bashkë me të birin. Mësohet se procedimi penal ndaj tyre filloi, pasi në pedonalen "Elez Isufi" të qytetit të Peshkopisë, kanë kundërshtuar punonjësit e policisë, si dhe kanë zhvilluar tubim të paligjshëm, në kohën kur Kryeministri i Republikës së Shqipërisë po zhvillonte aktivitet në qytetin e Peshkopisë. Burime policore pohuan se 26 protestuesit akuzohen për veprat penale: "Kundërshtim i punonjësit të policisë së rendit publik", kryer në bashkëpunim dhe "Organizimi dhe pjesëmarrja në grumbullime e manifestime të paligjshme".

"Ditën që ndodhi ngjarja na tha se do shkonte të merrte rrobat te banesa e të shoqit"

KURBIN

Violeta kishte vendosur të divorcohej nga bashkëshorti dhe ishte nisur për të shtëpia e saj në Rrëshen për të marrë vajzën dhe rrobat. Me vete mori edhe kunatën, gruan time, që ta ndihmonte me rrobat. Di që kanë pasur konflikte të vazhdueshme dhe për këtë, motra iku nga shtëpia. Ajo më ka treguar edhe shenjat e dhunës në trup". Kështu ka deklaruar në polici vëllai i 35-vjeçarës, e cila mëngjesin e së dielës ekzekutoi me katër plumba pistolette bashkëshortin, Kujtim Donaj. Një ditë pas ngjarjes së rëndë të ndodhur në tregun e Milotit, burime nga policia e Kurbinit bënë me dije se dyshohet që krimi brenda familjes të ketë ndodhur për shkak të marrëdhënieve të tensionuara të çiftit. Mësohet se gjatë marrjes në pyetje nga hetuesit e çështjes, autorja e ngjarjes së rëndë, Violeta Donaj është shprehur se babai i dy fëmijëve të saj konsumonte alkol herë pas here, ishte i dhunshëm dhe shpenzonte para në bixhoz. Po të njëjtat burime pohuan se 35-vjeçarja ka shprehur pendesë për krimin, ndërsa ndodhet në gjendje shoku. Për këtë shkak ajo do të merret sërish në pyetje nga hetuesit. Edhe familjarët e autores së krimin janë shprehur se Kujtim Donaj luante bixhoz dhe e dhunonte fizikisht bashkëshorten e tij. Madje, dhuna e vazhdueshme fizike u bë shkak që Violeta të merrte vendimin për t'u divorcuar nga i shoqi. Ndërkaq, në familjen e Kujtim Donajt në Mirditë janë hapur dyert e mortit. 42-vjeçari, i cili ishte tregtar në tregun e Milotit u përcoll pasditën e djeshme në banesën e fundit. Të afërmit e viktimës kërkojnë të dinë se cili është personi që i dha pistoletën 35-vjeçarës.

DËSHMIA E VËLLAIT TË VRASËSES

Një ditë para vrasjes së Kujtim Donajt, janë zbardhur

Vrasja në Milot, vëllai i autores në polici: Violeta do divorcohej nga burri, e keqtrajtonte

"Motra iku nga shtëpia e të shoqit dhe erdhi te ne. Më ka treguar shenjat e dhunës në trup"



Viktima Kujtim Donaj



35-vjeçarja e arrestuar, Violeta Donaj

detaje të reja në lidhje me ngjarjen. Mësohet se viktima kishte lënë shuma të konsiderueshme në bixhoz, ndërsa e dhunonte sistematikisht autoren e krimin, e cila disa ditë më parë është larguar së bashku me vajzën për tek banesa e vëllait të saj. Ky i fundit ka thënë në polici se 35-vjeçarja kishte disa ditë që ishte larguar nga shtëpia bashkëshortore, ndërsa mëngjesin e së dielës, kur edhe ndërmori aktin e rëndë, ajo u ka thënë familjarëve se do shkonte në shtëpinë e saj për të marrë rrobat e saj dhe të vajzës. Nëna e dy fëmijëve, një vajze 14-veçare dhe një djalë 7-vjeçar e shoqëruar edhe nga kunata (nusia e vëllait) ka marrë rrugën nga shtëpia e prindërve për në shtëpinë e saj, por askush nuk di të

thotë me saktësi pse ndaloi në treg, aty ku Kujtim Donaj ka qenë duke hapur mallin në tezgë. Vëllai i saj distancohet nga akti i rëndë, ndërsa shprehet se nuk e ka idenë se ku mund ta ketë gjetur armën e krimin Violeta. Ajo që di të thotë me siguri është fakti se e motra kishte shenja dhune në trup dhe konflikte të vazhdueshme me bashkëshortin e saj, që e kishin detyruar të ikte nga shtëpia. "Në s'kemi pasur dijeni në lidhje me ngjarjen. Di që kanë pasur konflikte të vazhdueshme dhe për këtë motra iku nga shtëpia. Violeta më ka treguar edhe shenjat e dhunës në trup, ndërsa nuk dija asgjë për veprimet që do të kryente. Dje (të dielën) më mëngjes na tha që do shkonte në shtëpi të mer-

rte rrobat. Shkoi bashkë me bashkëshorten time", - ka thënë vëllai i 35-vjeçarës së arrestuar për vrasje. Mësohet se 35-vjeçarja është shoqëruar nga kunata deri tek tregu, e aty i ka thënë se du-

het të mbaronte një punë. Ajo është afruar tek Kujtimi, kanë debatuar e më pas ka zbratur armën drejt tij, duke e lënë të vdekur në vend. Violeta Donaj akuzohet për veprat penale: "Armëmbajtjes

DËSHMIA E VRASËSES
Në gjendje të rëndë psikologjike, Violeta Donaj ka deklaruar gjatë shoqërimit në polici se shkak për aktin ekstrem ishte bërë dhuna sistematike nga i shoqi, e cila vinte si pasojë e xhelozisë që kishte ndaj saj Kujtimi. Po ashtu, bazuar në deklaratat e gruas, bashkëshorti luante në lojëra fati, gjë që kishte ndikuar në krijimin e vështirësive financiare.

Nëna e 3 fëmijëve, Antoneta Myrtaj: Kam frikë se do më vrasë

Goditi bashkëshorten me sqepar në kokë dhe në trup, arrestohet 65-vjeçari

MEMALIAJ - Një tjetër krim në familje ka ndodhur në jug të vendit. Një 65-vjeçar nga Memaliaj ka goditur me sqepar gruan e tij 57-vjeçare, e cila fatmirësisht ka shpëtuar nga vdekja dhe fatmirësisht ndodhet jashtë rrezikut në Spitalin Rajonal "Omer Nishani" të Gjirokastrës. Mësohet se Ferik Myrtaj e ka goditur disa herë të shoqen me sqepar në kokë e trup, por pavarësisht kësaj, policia e ka arrestuar atë për veprën penale "Dhunë në familje". "Nga specialistët për Hetimin e Krimit në Drejtorinë Vendore të Policisë Gjirokastrë u bë arrestimi në flagrancë i Ferik Myrtaj, 65 vjeç, banues në Memaliaj. Arrestimi i këtij shtetasi u bë pasi në banesën e tij, për motive të dobëta, ka goditur disa herë me sende të forta (sqepar) në kokë e trup bashkëshorten A.M., 57 vjeçe, banuese në Memaliaj", thuhet ndër të tjera në njoftimin zyrtar të policisë së Gjirokastrës. Ndërkaq, 57-vjeçarja ka treguar se Feriku nisi ta godiste në mes të rrugës mbrëmjen e së dielës, pasi kishte pirë.



57-vjeçarja Antoneta Myrtaj, në spitalin e Gjirokastrës

FIER

Një 80-vjeçar nga Fieri ka denoncuar në polici nusen e djalit, pasi pretendon se kjo e fundit e dhunonte psikologjikisht. Burime zyrtare nga policia lokale bënë me dije se bëhet fjalë për shtetasen me inicialet A.L., 47 vjeçe, e cila do të ndiqet penalisht. Ndërkohë për të moshuarin me inicialet Sh.L. është plotësuar kërkesa për lëshimin e urdhrin të mbrojtjes.

"Më shpëtuan kalimtarët. Iu luta që të mos më qëllonte. Kam frikë se do më vrasë, kur të dalë", u shpreh Antoneta Myrtaj. Ndërkaq, ajo ndihet e frikësuar se çfarë do ndodhë më pas mes saj dhe bashkëshortit. Antoneta tha se kanë tri vajza dhe burri që tashmë ndodhet pas

hekurave iu ka thënë të bijave se ishte penduar. Por edhe pas gjithë atyre vuajtjeve, gruaja akoma pretendon ta falë bashkëshortin dhe nuk e di se çfarë do të bëjë. "Në rini më rrihte, por e duroja, por kjo e fundit i ka kapërcyer limitet", pohoi 56-vjeçarja.

United Nations Development Programme

TENDER ANNOUNCEMENT

Subject: – RFP for ASSESSMENT OF CHALLENGES MUNICIPALITIES ARE FACING WITH SERVICE DELIVERY; CAPACITY BUILDING ON SERVICE DELIVERY, AND RE-ORGANIZATION OF SELECTED SERVICES

The United Nations Development Programme in Albania is seeking to receive offers from interested companies who wish to be considered for the aforementioned services.

Companies will be selected in accordance with established UNDP procedures. The offers must be delivered within the deadline set in a sealed envelope, clearly marked **UNDP/RFP 47196**

"RFP for ASSESSMENT OF CHALLENGES MUNICIPALITIES ARE FACING WITH SERVICE DELIVERY; CAPACITY BUILDING ON SERVICE DELIVERY, AND RE-ORGANIZATION OF SELECTED SERVICES"

For more details please refer to the link below:
<http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/operations/procurement/>

Relevant dates: All interested companies should provide their offer in the following address, not later than **20-Jul-18**

Address for communications:
 Email: procurement.al@undp.org
 Or
 Str. "Skenderbej", Gurten Center (Volkswagen building), 2nd floor
 Tirana, Albania

"Maqedonia e Veriut", priten të hapen diskutimet për në BE**Ministrja bullgare: Javën tjetër mund të jepet drita jeshile për negociatat me Maqedoninë**

Z kryeministrja dhe ministrja e Punëve të Jashtme e Bullgarisë, Ekaterina Zakhariëva, ka deklaruar se pas nënshkrimit të marrëveshjes për zgjidhjen e çështjes së emrit mes Maqedonisë dhe Greqisë, Këshilli për Çështje të Përgjithshme në BE, me të cilin kryeson ajo, javën e ardhshme mund të japë dritë jeshile për fillimin e bisedimeve për anëtarësim të Maqedonisë në BE. "Ne mbledhjen e Këshillit do të diskutohet për temën e zgjerimit. Nëse Këshilli jep dritë të gjelbër,

EKATERINA ZAKHARIEVA:

"Në mbledhjen e Këshillit do të diskutohet për temën e zgjerimit. Nëse Këshilli jep dritë të gjelbër, zgjidhja mund të konfirmohet në mbledhjen e Këshillit të Evropës më 29 dhe 30 qershor", -tha Zakhariëva për "Nova TV" bullgare.

zgjidhja mund të konfirmohet në mbledhjen e Këshillit të Evropës më 29 dhe 30 qershor", -tha Zakhariëva për "Nova TV" bullgare. Ajo shtoi se entuziazmi për zgjerimin i disa vendeve anëtare nuk është i madh, por tha se Maqedonia meriton dhe duhet t'i jepet perspektivë e qartë. Zakhariëva përsëriti

edhe një herë qëndrimin se Bullgarisë i intereson që Maqedonia të jetë stabile dhe të integrohet drejt NATO-s dhe BE-së. Ajo tha se marrëveshja mes Maqedonisë dhe Greqisë në asnjë mënyrë nuk do ta rrezikojë marrëveshjen për fëmijësi të mirë mes Shkupit dhe Sofjes, e cila u nënshkrua vitin e



kaluar nga kryeministrat Zoran Zaev dhe Boyko Borisov. Ligi për ratifikimin e marrëveshjes mes Greqisë e Maqedonisë së Veriut, të hënën pritet të kalojë në Qeveri, ndërsa më pas do të dërgohet në Kuvend për mi-

ratim. Për miratimin nevojitet shumicë e thjeshtë, konkretisht shumica e të pranishmëve në sallë. Nga kuorumi minimum i 61 deputetëve, 31 nevojitet që të votojnë 'pro'.

Mediat serbe: Delegacioni kosovar, në Bruksel pa praninë e Beogradit

Dialogu me Serbinë, Kosova i prezanton BE-së arritjet

Brukseli ende s'ka caktuar datën për vazhdim

Zyrtarët në Bruksel kanë thënë për Radi on Evropa e Lirë se ende nuk ka një datë të caktuar se kur do të mbahet takimi i ardhshëm ndërmjet delegacioneve të Kosovës dhe Serbisë. Takimi i radhës, pritet që të jetë në nivelin teknik, për t'i paraprirë takimit në nivelin politik. Maja Koçijancë, zëdhënëse e Përfaqësueses së Lartë të Bashkimit Evropian, Federica Mogherini, tha se është duke u punuar për caktimin e një date. "Unë nuk mund ta përmendi ndonjë datë në këtë moment. Në momentin kur ta kemi datën dhe të gjithë pajtohen, unë do ta bëj publike datën si dhe agjendën. Gjithmonë do ta bëj një gjë të tillë, por për momentin nuk mundem", -tha Koçijancë. Përderisa nuk dihet data e takimit të radhës, delegacioni i Kosovës ka udhëtuar për në Bruksel. Koordinator i Qeverisë së Kosovës për dialogun me Serbinë, Avni Arifi, tha për Radion Evropë e Lirë se delegacioni kosovar do të bëjë prezantimin e të arriturave në procesin e dialogut me Serbinë, para përfaqësuesve të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian. Ai tha se delegacioni i Kosovës do t'i njoftojë zyrtarët e BE-së për të arriturat, por edhe për gjeçet që pala serbe është duke i shaktuar procesit. "Ne jemi të përgatitur, do të flasim për angazhimet tona, por njëkohësisht do të flasim edhe për bllokadat që kemi. Ne nuk kemi njohuri se a është pala serbe në atë takim, por për hir të in-

**MAJA KOÇIJANÇË:**

"Unë nuk mund ta përmendi ndonjë datë në këtë moment. Në momentin kur ta kemi datën dhe të gjithë pajtohen, unë do ta bëj publike datën si dhe agjendën. Gjithmonë do ta bëj një gjë të tillë, por për momentin nuk mundem", -tha zëdhënësjë e Përfaqësueses së Lartë të Bashkimit Evropian, Koçijancë.

formimit të opinionit, ne nuk kemi takim me palën serbe", tha Arifi. Ai tha se pala nga Kosova i ka parashtruar kërkesat për takimin

dhe temat që pritet të diskutohen, por sipas tij, ende nuk ka ndonjë përgjigje. "Dy kërkesa i kemi bërë edhe në prill edhe në maj, për të ri-

filluar bisedimet dhe në rend të parë duhet të jetë energjia. Nuk kemi marrë përgjigje ende. Ne kemi pasur një ofertë për të dëgjuar prezantimin se deri ku kanë arritur rezultatet në hartimin e statutit, nuk kemi treguar interesim, sepse ka prioritetet më të mëdha. Për ne nuk ka marrëveshja më pak të rëndësishme dhe më shumë të rëndësishme, të gjitha marrëveshjet janë me rëndësi dhe jemi serioz në këtë as-

pekt", -tha Arifi. Delegacioni i Prishtinës do të qëndrojë në Bruksel për një "shkëmbim të rregullt të pikëpamjeve brenda dialogut" me Beogradin, ka konfirmuar Shërbimi Evropian i Punëve të Jashtme. Kryenegociatori i Kosovës në dialogun teknik me Serbinë, Avni Arifi, ka njoftuar se delegacioni i Prishtinës do të mbërrijë sot në Bruksel dhe do të prezantojë aktivitetet dhe arritjet e institucioneve të Kosovës për zbatimin e marrëveshjes së Brukselit. Ndërsa gazeta serbe, Tanjug, ka mësuar nga burimet diplomatike evropiane se është një takim dypalësh i delegacionit të Prishtinës dhe ndërmjetësuesve të Bashkimit Evropian, pa pjesëmarrje të Beogradit. Në Bruksel ekziston shpresa që në dy javët e ardhshme, deri në fund të qershorit të mbahet një raund i bisedimeve teknike, por edhe bisedime të nivelit të lartë mes presidentit Hashim Thaçi dhe Aleksandër Vuçiq. Avni Arifi ka bërë të ditur se do të kërkojë nga ndërmjetësuesit evropianë që të flasin për energjinë e jo të përqendrohen në formimin e komunave serbe. BE-ja për një kohë të gjatë është deklaruar se subjekt i bisedimeve janë marrëveshjet e pazbatuara, ndër to edhe formimi i komunave serbe.

SHKURT**OKB dënon ndarjen e fëmijëve nga prindërit në kufirin amerikan**

Shefi për të drejta të Njeriut i Kombeve të Bashkuara, Zeid Ra'ad Al Hussein, e dënoi, siç u shpreh ai, ndarjen "e pafalshme" të fëmijëve migrantë nga prindërit e tyre në kufirin e Shteteve të Bashkuara. Politika "zero tolerancë", e zbatuar nga administrata e presidentit amerikan, Donald Trump, ka shkakuar reagime gjithandej, sidomos qysh të dielën, kur SHBA ka shënuar Ditën e Baballarëve. "Ideja që një shtet përpjetë t'i pengojë prindërit duke shaktuar abuzime të tilla të fëmijët, është e pafalshme", -tha Al Hussein në një sesion të Këshillit të Drejtave të Njeriut në Gjenevë. Ai kërkoi që Uashingtoni ta përfundojë menjëherë, siç u shpreh, praktikën e "ndarjes së detyrueshme të fëmijëve" nga prindërit. Autoritetet amerikane janë duke ndaluar personat që tentojnë të kalojnë ilegalisht kufirin në SHBA - të rriturit i dërgojnë nëpër qendra të ndalimit ku mund të përballen me hetime për vepra penale, ndërsa fëmijët i çojnë në qendra të tjera ndalimi, larg prindërve. Autoritetet thanë se në gjashtë javët e fundit, gati 2,000 të mitur janë ndarë nga prindërit ose kujdesarët.

Holandë, furgoni përplas turmën gjatë një koncerti

Mbrojtësit e të drejtave të Një furgon goditi katër persona gjatë një koncerti në Holandë, në orët e para të mëngjesit të së hënës, duke vrarë një person dhe plagosur katër të tjerë. Në një deklaratë të policisë thuhet se makina u largua nga vendi i ngjarjes dhe është në kërkim. Mediat lokale e përshkruan mjetin si një autobus i vogël i bardhë. Incidenti ndodhi në koncertin "PinkPop", një festival popullor që u mbajt në provincën Limburg në jug të Holandës, pak pasi këngëtarë Bruno Mars kishte performuar. RTL raportoi se në vendngjarje ishte nisur një helikopter, ambulanca dhe forca të shumta policie. Bruno Mars ishte këngëtarë kryesor që mbylli koncertin tre-ditor në natën e së dielës, disa orë para se incidenti të ndodhte.

Kotzias: Grekët që janë kundër marrëveshjes, i presin në pushime ata

Protesta në Shkup kundër ndryshimit të emrit të Maqedonisë

Lideri i "Maqedonisë së vetme" me flamurin e Rusisë

Pas vendimit që u morr për emrin e Maqedonisë, nisën protestat kundër marrëveshjes që u bë midis Maqedonisë dhe Greqisë. Ato u përshkallëzuan mbrëmjen e së dielës në dhunë mes policisë dhe një grupi të protestuesve, të cilët tentuan të thyjnë kordonin policor para Kuvendit të Maqedonisë. Forcat e ndërrhyes së shpejtë përdorën gazin lotsjellës dhe bomba paralizuese për t'i shpërndarë demonstruesit. Policia arriti të shpërndante protestuesit e dhunshëm maqedonas që u mblohdën para Parlamentit të Republikës së Maqedonisë të dielën për të protestuar ndaj marrëveshjes në Prespë. Para parlamentit kishte rreth 2.000 protestues mes tyre kishte edhe persona me maska. Ajo që u vu re nga protestuesit e dhunshëm ishte shprehja e tyre pro Rusisë dhe kundër BE e kundër NATO-së, dhe këtë e dëshmon pamjet nga protesta para Kuvendit. Lideri i "Maqedonisë së vetme", Jançe Vançev me flamurin e Rusisë ka hipur mbi automjetin e policisë dhe ka valëvitur flamurin rus, shkruan tetovatos. Nuk ka informacione për të plagosur, ndërkohë që objekti i Kuvendit është blinduar nga forca të shumta policore. Protestuesit, në numër të vogël, gjatë tërë ditës kanë qëndruar para Kuvendit, ku mbajtën të bllokuar rrugën, në shenjë pakënaqësie ndaj marrëveshjes së arritur. Ata e kanë cilësuar atë si "kapitululluese për popullin maqedonas". Me marrëveshjen e nënshkruar të dielën midis ministrave të Jashtëm të Maqedonisë dhe Greqisë, Maqedonia do të njihet si "Republika e Maqedonisë së Veriut". Protesta u rrit në numër rreth orës 21:00 kur dhe kaloi në dhunë me policinë, shkruan rel. Gjatë ditës së hënë, në



HRISTIJAN MICKOVSKI:

Zoran Zaev është quajtur tradhtar të interesave kombëtare maqedonase. Partia jonë asnjëherë nuk do të njohë marrëveshjen e arritur në Prespë të Greqisë. Do të bllokojmë Kuvendin, ku për ndryshimet kushtetuese nevojiten dy të tretat e votave, por edhe gjatë referendumit që parashihet të mbahet në vjeshtë", -ka thënë kreu i VMRO-DPMNE-së.

qytetin e Manastirit është mbajtur edhe një tjetër protestë nga partia e opozitës, VMRO DPMNE. Lideri i kësaj partie, Hristijan Mickovski, ka kritikuar ashpër kryeministrin e Maqedonisë, Zoran Zaev, duke e quajtur "tradhtar të interesave kombëtare maqedonase". Ai ka thënë se partia që ai përfaqëson asnjëherë nuk do të njohë marrëveshjen e arritur në Prespë

të Greqisë, duke paralajmëruar kështu bllokim në Kuvend, ku për ndryshimet kushtetuese nevojiten dy të tretat e votave, por edhe gjatë referendumit që parashihet të mbahet në vjeshtë. Protesta janë paralajmëruar edhe për ditët në vazhdim. Ndërkohë që ministri i Jashtëm grek, Nikos Kotzias vazhdon që në paraqitjet e tij publike Maqedoninë ta quajë sipas emrit të

marrëveshjes, Maqedonia e Veriut edhe pse marrëveshja nuk ka hyrë në fuqi zyrtarisht. Kotzias theksoi se të njëjtët grekë që protestojnë kundër marrëveshjes miqësore me fqinjët, gjatë gjithë kohës i presin në pushime po këta fqinj. "Këtë javë Maqedonia e Veriut do ta ratifikojë marrëveshjen, pastaj do të mbajë referendum, do ta ndryshojë Kushtetutën dhe mandej ne do ta ratifikojmë marrëveshjen. Rrezikojnë për shkak se na besojnë se atë që e themi, atë e mendojmë. Ekziston një realitet që duhet ta zhvillojmë në dobi të dy popujve, që ta zhvillohen edhe ekonomia edhe shoqëritë e dy rajoneve", -ka thënë Kotzias.

NIKOS KOTZIAS:

"Këtë javë Maqedonia e Veriut do ta ratifikojë marrëveshjen, pastaj do të mbajë referendum, do ta ndryshojë Kushtetutën dhe mandej ne do ta ratifikojmë marrëveshjen. Rrezikojnë për shkak se na besojnë se atë që e themi, atë e mendojmë. Ekziston një realitet që duhet ta zhvillojmë në dobi të dy popujve, që ta zhvillohen edhe ekonomia edhe shoqëritë e dy rajoneve", -ka thënë Kotzias.

marrëveshje, ndërsa secila marrëveshje përmban kompromis dhe detyrime. Njerëzit e dy vendeve nuk janë në luftë, qytetarët e njëjtë që protestojnë me kënaqësi të madhe i presin si klientë gjatë gjithë vitit", tha Nikos Kotzias, ministër i Jashtëm i Greqisë. Kotzias duke komentuar protestat e djeshme tha se grekët po thyjnë stereotipet për shkak se numri fillestar i protestuesve ka rënë dukshëm, nga 1 milion në 100 000 dhe në fund 4 000, që sipas tij dëshmon se grekët po i thyjnë stereotipet.

SHKURT

Policia arreston drejtorin e 'Audi'-t në Gjermani

Policia gjermane arrestoi drejtorin ekzekutiv të kompanisë së prodhimit të automjeteve 'Audi'. Rupert Stadler u arrestua me kërkesë të prokurorisë së Mynihut, pasi ai është në listat e personave nën hetim për të ashtuquajturin skandal "Dizelgate". Skandali daton para 3 vitesh, kur u zbulua se disa firma gjermane u kishin vendosur automjeteve të tyre aparatura që manipulonin të dhënat për cilimin e gazrave. Sipas prokurorëve, Stadler u arrestua pasi rrezikon të manipulojë provat e përfshijnë në skandal.

Goditen nga treni, tre të vdekur në Londër

Tre persona janë vrarë, pasi u goditën nga një tren në jug të Londrës të hënën në mëngjes. Policia Britanike e Transportit shkoi menjëherë në vendngjarje pasi u gjetën disa trupa të vdekur. Të tre personat u shpallën të vdekur në vendngjarje nga Shërbimi i Ambulancës në Londër dhe zyrtarët po punojnë për të identifikuar viktimat dhe për të njoftuar familjet e tyre. Policia i përshkroi vdekjet si të pashpjegueshme, pasi po përgjigjet të përcaktojnë se si ato përfunduan në shina. Shërbimet e trenit janë shtyrë, ndërsa po kryhen hetimet.

Bilanc lufte 58 të vdekur dhe 392 të plagosur

Bilanc lufte nga aksidenti gjatë festës së Fiter Bajramit në Turqi. Agjencia shëtitërore e lajmeve "Anadolu Agency" raporton se 58 persona kanë humbur jetën dhe 392 të tjerë janë plagosur në aksidentet automobilistike që kanë ndodhur anekënd Turqisë gjatë festës. Agjencia raporton se në ditën para Bajramit, kur qindra mijëra persona nisën nga Stambolli dhe Ankaraja drejt vendlindjeve të tyre, kanë humbur jetën 11 persona dhe janë plagosur 70 të tjerë. Në ditën e parë të festës vdiqën në aksidente 15 persona dhe u plagosën 98 të tjerë. Në ditën e dytë bilanci ishte edhe më tragjik, 17 të vdekur dhe 118 të plagosur, ndërsa në ditën e tretë dhe të fundit të Bajramit, vetëm deri në orën 17:00, 15 persona humbën jetën në aksidente dhe 106 u plagosën. 4 prej shembujve më tragjikë ato të Eskishehirit dhe Shirnakut, ku mëngjesin e së dielës humbën jetën nga 3 persona nga e njëjta familje, në Kutahya 4 persona nga e njëjta familje dhe në Kastamonu 6 të afërm që po udhëtonin me të njëjtën makinë, nga OKB.

Marrëveshja me Greqinë, Ivanov pritet ta firmosë

"Maqedonia e Veriut", qeveria maqedonase miraton ratifikimin e marrëveshjes për emrin e ri

Qeveria e Maqedonisë ka nisur mëngjesin e së hënës seancën për ratifikimin e marrëveshjes së arritur dje në Prespë, midis qeverisë së Maqedonisë dhe asaj të Greqisë, për ndryshimin e emrit nga Republika e Maqedonisë në Republika e Maqedonisë së Veriut. Seanca ka zgjatur më pak se gjysmë orë dhe është miratuar në unanimitet. "Në seancën e 74-të, Qeveria e Republikës së Maqedonisë ka shqyrtuar dhe aprovuar propozimin ligjin për ratifikim të mar-

rëveshjes përfundimtare për zgjidhjen e dallimeve, siç përshkruhet në Rezolutën e Këshillit të Kombeve të Bashkuara 817 (1993) dhe 845 (1993), ndërprerje të Kornizës Kohore të vitit 1995 dhe vendosjen të partneritetit strategjik ndërmjet palëve, me propozim të Ministrisë për Punë të Jashtme. Propozim-ligji për ratifikim do të dorëzohet në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë", -thuhet në njoftimin e Qeverisë së Maqedonisë, shkruan Alsat M. Pas miratimit në qeveri ditën e djeshme

marrëveshja u dërgua në Kuvend për miratim, që me shumë gjasa do të vendoset në rend dite këtë të mërkurë. Për miratimin e saj në Kuvend nevojitet një shumicë e thjeshtë, 61 deputetë. Nga kuorumi minimum i 61 deputetëve, 31 nevojitet që të votojnë 'pro'. Sipas procedurave, ligji më pas edhe një herë dërgohet në presidencë. Ndërkohë, presidenti Ivanov në afat prej shtatë ditëve duhet të firmosë të njëjtin. Përdërisa Ivanov përdor të drejtën e vetos, marrëveshja kthehet prapë



në procedurë parlamentare, ndërsa atëherë do të nevojiten minimum 61 vota të deputetëve për miratimin e ligjit dhe i njëjti përsëri kthehet tek presidenti, i cili sipas Kushtetutës është i obliguar që ta firmosë. Mirëpo presidenti Ivanov tashmë ka bërë të ditur qëndrimin e tij se nuk do të firmosë një marrëveshje të tillë. Implementimi i marrëveshjes do

të zhvillohet në disa etapa. Do të hyjë në fuqi pasi dyja palët do ta pranojnë në përputhje me procedurat e brendshme, ndërsa përdërisa cilado palë nuk e pranon marrëveshjen atëherë ajo nënkupton se e njëjta nuk vlen. Qytetarët do të thonë fjalën e tyre në referendum, i cili pritet të mbahet në shtator ose tetor.

TEATRI KOMBËTAR

Fatmira Nikolli

Inxhinieri bën thirrje të rrafshohet, Mirush Kabashi: Është Meka jonë

Njëri i bie thundrës e tjetri patkoit, kreu i bashkisë flet për negociata, artistët protesta kundër çdo natë

Pas dëgjësës së parë me artistët për çështjen e Teatrit Kombëtar, tekta kreu i bashkisë Erion Veliaj flet për 'tone të ulura' e negociata, artistët nga ana tjetër, pak metra nga zyra e tij, protestojnë. Çdo natë! Një palë i bie thundrës e tjetra patkoit. Takimi mes tyre, shkoi për drej. Tanimë, artistët kundërshtojnë çdo gjë që kreu i bashkisë tha në atë takim, ku palët jo vetëm që nuk ranë dakord, por as nuk diskutuan si e sa duhet, për atë që i ndan truallin e teatrit dhe mënyrën e ndërtimit të një teatri të ri. Ata do vijnë të protestojnë, deri kur të tërhiqet projektligji që i hap rrugë shembjes së teatrit, i njohur ndryshe si projektligji që përcakton mënyrën e bashkëpunimit me privatën për teatër të ri në truallin e të vjetrit, por me disa metra më pak përmes PPP.

Ndërkaq, Veliaj, pas Pragës e Prizrenit në Tiranë mbledh grupe të tjera interesi. Sekush në takimin që organizon duket sikur fton ata që mendojnë njësoj me organizatorin. Ndërsa në podiumin e artistëve ngiiten qytetarë me profesione të ndryshme që duan të mbrojnë truallin e pronën e teatrit (deri edhe të dhurorin tokë për teatrin), në tryezat përballë kreut të bashkisë, ka qytetarë që mendojnë se duhet shembur.

PROTESTA E PËRDITSHME

Edhe dje, artistët dolën në protestë në orën 19:00. Para godinës ata kundërshtojnë fuqimisht shembjen dhe tjetërsimin e truallit. Në fjalën e mbajtur dje, aktori Mirush Kabashi dha arsyt pse është kundër shembjes. "Problemin mos ta trajtojmë në baza shembujsh e shifrash, por në baza parimesh. Nëse merrej një vendim duhej marrë i diskutuar me komunitetin e artistëve, nëse duhet të rikonstruktohet ky teatër apo të ndërtohet një nga e para. Nëse biem dakord duhet të jetë në projektin që do bëhet e gjithë sipërfaqja e teatrit ekzistues. Për mua ky duhet të rikonstruktohet si teatër se ka një histori të lavdishme, ky teatër është Meka e kulturës shqiptare", tha ai.

Ai shtoi se "Veliaj u përpoq të na kujtojë se është rritur buxheti për kulturën por ne i kujtuam se Kosova e ka dy herë



më të madh buxhetin për kulturën, ndërsa Maqedonia 3-4 herë. Është një turp për politikën shqiptare që ne artistëve na kanë imponuar një ligj diktatorial, se nuk më del inati në këtë mes. Ne atëherë konsideroheshim ndihmës të partisë në edukimin e masave, se ajo bënte politikën për artin dhe artistët duhet të prodhonin një art të lustruar socialist, jo realist". Kabashi, kujtoi se edhe sot pas 30 vitesh, politikat e artit i vendos qeveria në mbledhjet e qeverisë e nuk duhet të ketë politikë qeveritare apo partitake për artin, ai duhet t'i nënshtrohet vetëm Kushtetutës.

DËGJESA II E VELIAJT

Të hënën, kryetari i Bashkisë, Erion Veliaj, zhvilloi një dëgjësë të dytë publike me arkitektë dhe urban-

istë për çështjen e Teatrit Kombëtar. Para tyre ai tha se me dëgjësën e parë me artistët dhe aktorët, u arritën disa gjëra. Sipas tij, u arrit që tonet e diskutimit të aktorëve me bashkinë të ulen. Veliaj shtoi se të gjithë bien dakord për një teatër të ri, por ngelet për t'u diskutuar mënyra sesi ky teatër do të ndërtohet. "Aktorët janë të rëndësishëm, por ashtu janë të gjithë, urbanistët, qytetarët. Pjesa e dytë e dëgjësës iu dedikohet urbanistëve dhe arkitektëve. Pse ndodh tani kjo dëgjësë? Kemi marrë një propozim për të zhvilluar atë zonë. Po flasim për një arkitekt yll, që ka vënë firmën e vet në disa nga ndërtimet më të mira në botë. Pse po ndodh tani? Siç e kërkon legjislacioni shqiptar, siç ka ndodhur me parlamentin

dhe të tjerat. Të hapim një negociatë. Bashkia të jetë pala që e merr në shqyrtim. Kështu që këtu nuk bëhet fjalë për të vendosur për projektin, apo për të prishur teatrin", tha Veliaj. Shtoi se këtu bëhet fjalë për të folur dhe për të hapur një negociatë ku bashkia, me institucionet e tjera dhe komunitetin e artistëve të jetë pala që e merr në shqyrtim. "Sot jemi në këtë fazë. Falënderimi i parë shkon për komunitetin e artistëve. Ne kemi pasur një komunikim shumë intensiv dhe pas dëgjësës më vjen mirë që konstatohet disa gjëra. Së pari, që kemi ulur tonet dhe të arrimë të kuptojmë që kjo tavolinë dhe tavolina e para të ditës përfaqëson ajkën e këtij qyteti. Ajo që zbulova nga dëgjësja është që kishte shumë më shumë konsen-

turor dhe i dedikuar për teatrin. Pasi teatri ka specifika të veçanta. Duhet të ristrukturohet, dhe nëse duhet të ristrukturohet, ju si arkitektë i dini shumë mirë kushtet si duhet të jenë përmasat. Duam të riparojmë diçka që nuk riparohet. Situata është e agravuar. Ne jemi inxhinierë, s'na duhen fare gjërat e tjera".

Pas tij, fjalën e mori kreu i Shërbimit Zjarrfikës sipas të cilit teatri s'mbrohet dot nga zjarri e edhe sikur një shkëndijë e djeg godinën.

"Rezervat ujore dhe pompat e furnizimit me ujë mungojnë. Sistemi i diktimit sinjalizimit dhe shpëtimimit nga zjarri mungon. Sistemi elektrik është jashtë kushteve teknike. Një shkëndijë elektrike mund të shkaktojë zjarr në gjithë godinën. Daljet e emergjencës thuajse mungojnë fare. Duhen minimalisht 6 dalje emergjente ndërkohë që funksionojnë një ose dy. Tavanet e objektit janë të pasigurta e të çara për qëndrimin e spektatorëve. Krugët e kalimit janë jashtë kushteve teknike", tha Shkëlqim Goxhaj, kreu i Shërbimit Zjarrfikës. Ai shtoi seteatri nuk përmbush asnjë nga kushtet për të vijuar punën, pasi nuk mund të mbrohet nga zjarri.

REPLIKA E VASILIT

Aktori i njohur Laert Vasili u është kthyer të gjithë kolegëve të tij që e kanë sulmuar pas debatit për shembjen e Teatrit Kombëtar. I ftuar në emisionin 'Studio e Hapur' në 'News24' Vasili tha se pasi u morën me të, aktorët që protestonin u morën edhe me nënën e tij, madje përderi edhe disa nga shprehjet që sipas tij i adresoheshin atij, shkruan 'BalkanWeb'. Po ashtu ai tha se shumica e artistëve duan teatër të ri. "Nuk bëhet fjalë për shumicë apo pakicë. Bëhet fjalë për shumicën e aktorëve të cilët ndonëse nuk marrin mikrofonin të bërtasin dhe të ofendojnë. Tani mbaruan me ne dhe nisën me nënat tona. I referohen lëmit që ai ka turrur. Shumica e aktorëve janë për teatër të ri. Kërkohej që nga 2004-ta. Ku instituti i Zjarrfikës deklaroi që duhet një teatër të ri. Teatri i ri konsiston në këtë gjë, pasi pas studimit doli se ishte godinë jashtë standardit. Janë bërë dy ndërhyrje në teatër. Në këto dy ndërhyrje është carë godina e teatrit dhe janë futur disa pjesë të tjera. Ajo që zhvillohet para Teatrit Kombëtar ka kaluar në fyerjet e epitetit të padobishme. Vetëm artistët s'mund të flasin kështu. Mua më kanë quajtur qurrash, lëtyra... edhe termin bira kur*ash. Se na ndajnë dy pikëpamje s'do nisim të shahemi nga nëna", tha Vasili

I pranishëm në dëgjësë, ishte edhe inxhinieri Agron Hysenlliu. Ai tha se gjendja e godinës është më e rëndë nga sa duket. Sipas tij, godina duhet rrafshuar. "Kemi kryer ekspertizë për Teatrin. TK është jashtë funksionit. I kemi thënë dhe drejtorit të Teatrit që këto gjëra duhen diskutuar. Shumë nga lozhat janë mbyllur për t'u kthyer në depo. Këtu mund të vriten njerëzit nga konfuzioni se dyert janë të mbyllura. Sistemi i zjarrit është jashtë funksionit. S'ka kushte higjieno-sanitare, janë skandalozë. Duhet patjetër që drejtoria e teatrit të veprojë. Në dimër mund të hysh me kapotë, në verë është vapë. Akustika është me probleme", tha Hysenlliu.

Duke e vënë theksin se teatri duhet të pezullojë aktivitetin e tij, inxhinieri shtoi se "teatri duhet të rrafshohet dhe të konceptohet me ato kushte teknike që janë të sotme për një objekt që është social kul-

KOMENT

Të pamëshirshëm qenkan gjithë hajdutët. Ç'duan vallë këta të pangopur që gjithkund veç ndotin me plehun e parasë dhe lakmisë pa kontroll, ç'duan këta djaj që blejnë me 30 aspra bukurinë e pashoqe e të dëlire që shekujt me zor e kanë krijuar mes shtërzimesh dhe ekuilibrit në pamatësinë e kohës?

Nga Josif Papagjoni

Uji i hirtë i Valbonës



Këto dy ditët e fun dit, në vazhdë të miqësisë dhe dëshirës për të prekur natyrën, shkuam në Valbonë së toku një grup shokësh. Ishte nga udhëtimet më të bukura që kam bërë. Mbresën e keqe që të lë rruga Vau i Dejës-Koman, e gjitha e degraduar, me gropa dhe e vrazhdët, e tejkalon saora teksta ti hipën në traqet dhe nis udhëtimin në ujanën e bukur Koman-Fierzë. Unë jam bregas dhe afërmendsh ujën e kam brenda vetes. Sakaq 5 vjet kam qenë në ato vise të rrethit të Pukës kur isha i ri, disa relieve të thepisura e plot pyje i kisha shkelur me këmbë vetë në vitet '70 me brigadat kulturore që bënin verës fshat me fshat dhe buzë Drinit. Madje ruaj një foto edhe kur nota në Drin si i fantakur, paqka se rrjedha ishte e fuqishme. Imazhet e dikurshme që vinin nga kujtesa, përplaseshin me imazhet e reja të kësaj udhe thuasje poetike, si nëpër filma. Male mbytur në gjelbërim të thellë, shpesh të ngushtuar e brinjë më brinjë, kridheshin në këtë ujanë herë blu e herë të gjelbër gjegjësisht lojës së diellit në syprinë të saj. Veq syri mund ta ndiejë bukurinë të tërën, ajri i pastër në mushkëri hyn në çdo pejëz. Një grup turistësh kanë mbushur traqet dhe zhurmë bënë pafundësisht foto. Shumë pak rrinë brenda kabinës, të shumtët bredhin poshtë e lart hapësirave të traqetit, disa ulen në shesh sikur të qenë diku në një piknik. Trak-trak shkrepin gjithkund aparatet fotografike.

Por tekta natyra dhe Zoti e ka parapëlqyer me bukuri të tilla të rralla këtë vend, tekta syrin, shpirtin dhe lëkurën t'i këndellin peizazhet e mrekualeshme e si të ëndërrta, ja ku të shfaqen qindra e mijëra hedhje plastike, që të kujtojnë se nuk qenke aspak në "Eden"... Ujana sikur zbardhet, fytyra i prishet, i mbushet kreyt me vurrata, njolla, puçrra. Janë shenjat e një edukate të mangët që ne kemi, madje sjellje prej budallenjsh, injorantësh, të pa-përgjegjshëm dhe provincialësh, që e ndotin lehtësisht me duart tona atë bukuri të virgjër që natyra na ka falur bujar-

isht. Një barbari, ç'bëhet kështu, grindesha me veten unë, pse jemi kaq të pamëshirshëm me natyrën? Me hipnin nervat me këtë mosk-okëçarje prej shqiptarësh të pagdhendur, pisanjosë, që flakin në ujë a mbi bar gjithë plehun e kënaqësisë së tyre të çastit pa menduar se ka dhe një ditë tjetër më pas, se ka dhe të tjerë që do të jetojnë më pas, se ka dhe sy e shpërtra ndryshe e përpos kënaqësisë së stomakut tënd që e flak pa tekllif në ujë shishen, qesen, plastikën e shumëçka tjetër pa menduar se ajo bukuri s'është vetëm e jotja, por edhe e imja, e atij, e asaj, e atyre, e të gjithëve, e brezave pas nesh.

Eh, sa kohë na duhet të bëhemi p.sh. zviceranë apo austriakë që respektojnë dhe i përfalen natyrës! A s'mundej vallë një anije e vogël t'i mblidhte gjithë këto hedhurina, pak nga pak, duke e futur shpenzimin në koston e pastërtisë së asaj ujanë të rrallë? Po në Pierzë, kur traqeti ankorohet, nuk mund ta shtrijojmë me beton vendin që makinat të dalin lehtësisht dhe pa rrezikuar? Kaq të sh-trenjta qenkan 3-4 betoniera që rrethi i Pukës a i Tropojës nuk na i paskan?! Ose qeveria xhanë, Ministria e Turizmit? Nejshe...

Mbërritëm më në fund në resortin turistik MIRASHI, diku në thellësi, në këmbët e masivit malor, nën barkun e Valbonës që buronte e strukeje nën zallishte. Një

“
Dhe flasin për demokraci, kur si shushunjat a siç thoshte Noli si "kolltukofaget", s'e lëshojnë karrigen, veçse urinojnë dhe ndotin gjithnjë e më shumë. Dhe pres e pres vetingun e politikanëve hajdutë, duke i parë se si do ikin me bishtin në shalë, njësoj si këta gjykatësit e korruptuar gjer në instancat më të larta të drejtësisë, që nuk

Zvicër e jashtëzakonshme. Diçka e rrallë. Fantastike. E them pa frikë: e Perëndishme. Katër përmasa

të bëra bashkë në një martesë prej mitesh ma mbushën zemrën: mali, pylli, qielli, uji. Krejt pamja të ngopte, ti drithëroje nën atë peshe krepash krenare mbi kokën tënde, me borën e patretur përsipër dhe pyllin e bredhave e pishave. Teksa ia ngulja sytë atij vijëzimi shkrepash të njëpasnjëshme me konfigurime marra-mendëse, mendja ime donte të bërtiste: Olimpi i hyjnive greke duhet të ishte pikërisht këtu! Nuk e poetizoj aspak, është diçka që ndjehet, nuk shpjegohet. Duhet të jesh vetë atje. Fjala është e belbët, flet veç ndjesia. Këtu duhet të fillonte miti dhe dialogu mes Zotit dhe Njeriut, të Madhes dhe të Voglës, të parokshmes dhe lehtësisht të prekshmes, të Madhërishtes dhe Humanes... Këtu duhet të bridhte Muji dhe Halili me gjogët e tyre që linin gjurmë me patkonjtë dhe vrapin, këtu duhet të qe Ajkuna. Eh, e shoh se e teprova me patosin tim, por mësuar mes ngushtësisë së kryeqytetit, pluhurit, tymit, makinave, trotuareve ku përplasesh me supin e tjetrit, kjo hapësirë malore dhe e madhërishtes sikur t'i hap mushkëritë, ta zgjeron mendjen një grimë duke e për copë e çikë ngulftajen prej rrëmujës dhe "ngjeshjes" së kryeqytetit, godina, rrugë e turma njerëzish në nxit, të cilat sikur të mbërthejnë si në darë dhe të futin pa kuptuar drejt një klaustrofobie të

lloit tjetër.

Hëngrëm një drekë, donim të shijonim peshkun e ujërave të ëmbla të Valbonës, por për fat të keq mungonin duar kuzhinierësh shijehollë; mungonte tradita e këtij ushqimi (peshkut), por dhe e një ushqimi ndryshe, specifik, prorrizonës, që ia vlenë edhe mbamendja ta fuste thellë vetes si diçka të papërsëritshme. Turizmi, ndoshta fillon me natyrën dhe virgjinitetin e saj, por duhet të përfundoj ëmbël te goja, gjuha dhe stomaku. Dhe kjo kërkon punë, specialitet, njerëz të dimë, kuzhinë shijehollë. Sepse investimi i kryer atje ishte multidimensional dhe meritort. Afërmendsh se nuk janë vetëm gurët, buronjat, pemët dhe peizazhi në një resort turistik, as vetëm krevatet, dhomat, banjat. Ai vendaq i bukur thërriste nga bota plot turistë, pleq e të rinj, me makinat-shtëpi (numërova 10 të tilla vetëm në atë resort), me biçikleta, motorë, pajisje alpinistike etj. E pra, ka ardhur koha që të bëhemi më të zotë, t'i lëmë grindjet e përbindshme politike dhe t'i japim krah parasë që krijon kënaqësinë dhe lumturinë, për të tjerët dhe për veten.

Teksa ktheshim kaluam dhe në dy vende ku dhembët e skrepave po kafshonin dhe un, brinjët e maleve, dhe ujtë e kulluar të Valbonës e kishin bërë të bardhë si hirë djathi nga pluhuri i gërryerjes së pamëshirshme të maleve, jo i kthjellët e i

kaltër sikurse ai lumë është. Po ç'dreqin duan këto skrepa e kantiere në Valbonë, grindesha me veten tekta imazhi im po prishej e thyhej dysh. Dhe u jepja të drejtë banorëve të asaj zone të bekuar kur flasin të zemëruar se Valbonën e tyre nuk do ta lëshonin në duart e hajnave, të skrepave dhe të politikës, të shtinjakëve të djeshëm që shiten madje si valbonë-dashës dhe ia patën ngulur thikën asaj pas shpine me vendime idiote hidrocentralesh, të djeshme a të sotme...

Të pamëshirshëm qenkan gjithë hajdutët. Ç'duan vallë këta të pangopur që gjithkund veç ndotin me plehun e parasë pa kontroll, ç'duan këta djaj që blejnë me 30 aspra bukurinë e pashoqe e të dëlire që shekujt me zor e kanë krijuar mes shtërzimesh dhe ekuilibrit në pamatësinë e kohës? Dhe tekta ikja hipur mbi katër goma, inati s'më lëshonte. Po mjaft, or egërsira, mjaft! Dhe i lodhur siç isha nga rruga, doja të merrja helmin e përditshëm të ekraneve të ndryrë të televizorëve, si drogën një trup dhe një mendje varur; e lodhur, dhe ja tek mu shfaqën një zhgan hileqarësh, hajdutësh, gjysma injorantë e me xhepat plot, kokëbosh, por tejet mburraveçë, dhe gjysma duke kërcëlltur dhembët që të vijmë në pushtet dhe të zhvatim çka mbetur ende, se po u mbarojnë paratë e mandatit të mëhershëm dhe të shtojnë banja të tjera në vilat e tyre luksoze. Kur do shporret kjo klasë politike, kur këto fytyra me nga 30 vjet që na kanë mbirë aty do të zhduken sysh?! Dhe flasin për demokraci, kur si shushunjat a siç thoshte Noli si "kolltukofaget", s'e lëshojnë karrigen, veçse urinojnë dhe ndotin gjithnjë e më shumë. Dhe pres e pres vetingun e politikanëve hajdutë, duke i parë se si do ikin me bishtin në shalë, njësoj si këta gjykatësit e korruptuar gjer në instancat më të larta të drejtësisë, që nuk justifikojnë dot paratë e vjedhura.

Ja, e nisa me Valbonën, këtë dhuratë të hyjnueshme, dhe e mbarova me zemërimin tim, besoj edhe të mijëra të tjerëve, për spektaklin e përzishëm e të përsëritshëm të së enjtes së parlamentit - kjo komedi groteske a kjo paçavër e neveritshme politike që aq shumë na lodh ende...

Opinion

i Ditës

Takimi i Singaporit: Sukses i madh apo dështim i madh

Nga Vasil Kureta

(vijon nga faqja 1)

... të SHBA Trump dhe udhëheqësit, me dorë të fortë koreano-verior, Kim Jong Un. Nuk kishte vetëm retorikë armiqësore, nga Kim Jong Un dhe Koreja e Veriut, por dhe avancim konkret të programit bërthamor, shoqëruar me prova të tipave të raketave për to. Zhvillime të tilla, kur nuk ka dhe shumë informacion, i lënë rrugë e frymëzim të gjitha mundësi dhe hamëndësi. Ajo që nuk ka diskutim tashmë është fakti, që dy pozicione armiqësive të avancuara, dy filozofi politike të kundërta ekstremisht, në mënyrë të pabesueshme ulën në tavolinë, jo ekspertë, por presidentin e SHBA Trump dhe fuqinë më të madhe e demokratike në botë, udhëheqëse e Perëndimit dhe shtetin e mbyllur e të drejtuar me dorë fortë nga Kim Jong Un, por që zhvillonte me kokëfortësi programin e armëve bërthamore, përmes provave të njëpasnjëshme, shoqëruar me kërcënime konkrete të përdorimit të tyre ndaj SHBA.

Ky hap shfaqti me të drejtë interes shumë të madh, se u vunë përballë, jo me armë lufte, po me argumente, dy filozofi e dy botë me drejtime krejtësisht të kundërta. Për këtë arsye, ulja në tavolinë, apo vlerësimi i alternativës së dialogut në vend të kërcënimit, i përgjegjshmërisë ndaj përgjegjshmërisë, diskutimi për një situatë paqe, në vend të kërcënimit dhe përgatitjes për luftë, pra ky takim në Singapor, nuk ka mëdyshe se ishte një sukses i madh diplomatik. Ai hapi një mundësi e rrugë të re. Ky hap shënon një fillim të mirë, por që përmban një vazhdim tepër të vështirë, që do të tregojë, nëse ulja në tavolinë, ishte një taktikë, për të fituar kohë të nevojshme nga Kim Jong Un, për t'u lehtësuar nga trysnia e shtuar e Perëndimit, ndaj kërcënimeve konkrete koreano-veriore, apo ka shanse për t'i hapur rrugë një njëllor realizmi apo përgjegjshmërie nga pala koreano-veriore. Edhe kostoja e madhe ekonomike e financiare ka rolin e saj të madh në këtë ndryshim sjellje të Koresë së Veriut, apo futje në rrugën e një dialogu, që mendohet se do të zgjasë. Nuk përjashtohet, që ulja në tavolinë të jetë menduar edhe si një hapësirë lehtësimi frymëmarrjeje të nevojshme për Korenë e Veriut. Nëse vërtet kjo ulje në tavolinë është nxitur edhe nga ndonjë shkëndijë e fillimit të një përgjegjshmërie konkrete nga pala koreane, atëherë vërtet është një lajm i mirë ky takim i kryer tashmë. Nëse nuk do të kishte takim apo nuk do të konsumohej ai, atëherë ky do të ishte një dështim i madh i diplomacisë. Tani që u



krye, qëndron mundësia e mençuria që të shtrohet e ushqehet një sukses i vërtetë. Gazetarët në konferencën për shtyp me presidentin amerikan Trump, u shfaqën të uritur të mësonin më shumë rreth bisedimeve të zhvilluara, përjetë deklarates publike, që të gjykonin më realisht në se ky takim ishte një sukses apo dështim real, që është dhe misioni i shtypit, por që presidenti Trump nuk u a mundësoi të mësonin më shumë. Arritjet e këtij takimi nuk kanë lidhje me ngutjet. Në këto kushte dhe informacioni që është publikuar edhe pse ka shpresë të mendohet suksesi, të qenit realist të shtyn dhe të një mundësi dështimi të këtij aksioni. Shpresat janë të hapura vërtet sado i vogël qoftë suksesi i fillimit. Ka vërtet prirje për arritje të mëtejshme.

Presidenti amerikan, që disponon informacionin e plotë, në një farë mënyre u shpreh optimist dhe i sigurtë, teksa theksoi se ky takim do t'i hapi rrugën një ndryshimi të madh. Është kjo një dëshirë personale apo një mundësi reale? Aq informacion sa është publikuar, duket se arritja e parë është heqja dorë nga retorika e luftës dhe kërcënimit, për t'i lënë kështu mundësi dialogut dhe një situatë paqje në gadishullin Korean. Për të ushqyer suksesin dhe besimin e goditur rëndë, Presidenti Trump ofroi garanci amerikane për sigurinë e Koresë së Veriut, ndërsa Kim Jong Un ofroi angazhimin e vendosur për të përfunduar denuklearizimin e gadishullit Korean. Pra, ajo që duket hapur është fillim i një lëvizjeje për rikthimin e besimit, që është vërtet jashtëzakonisht i rëndësishëm. Edhe pse u shfaq rastësi, ndërimi i stilolapsit, të vendosur për

presidentin koreano-verior Kim, që të nënshkruante deklaratën, siç ishte vendosur edhe për presidentin amerikan, apo nënshkrimi i deklaratës me stilolapsin e sjellë nga Koreja e Veriut, është tregues shumë i qartë, se sa nën zero ishte besimi mes këtyre dy vendeve. Dhe në se ky takim, do të tregojë një fillim të rikthimit të besimit, mund të vlerësohet vërtet sukses.

Ai që ka pritur çundra të mëdha apo kthesa rrënjësore të menjëhershme, vërtet ka qenë jo realist dhe i gabuar plotësisht. Ndryshimet e rëndësishme e cilësore kërkojnë kohën e tyre të nevojshme, por hapja rrugë e procesit vërtet është i rëndësishëm jashtëzakonisht. Kjo ka ndodhur dhe në këtë ngjarje të fundit, i është dhënë një mundësi ndryshimit të madh. Fillim i mirë dhe i besueshëm është ky që ka filluar në këtë takim dhe që është konkretizuar në dakordësinë e nënshkruar se SHBA dhe Koreja e Veriut angazhohen të krijojnë marrëdhënie të reja mes tyre, në përputhje me dëshirën e dy popujve të tyre për paqe e prosperitet dhe se të dy vendet i bashkohen përpjekjeve për të ndërtuar një regjim paqje në rajon. Ky deklarim është vërtet realist, sepse regjimi i paqes në këtë rajon, varet dhe nga qëndrimi e kontributi dhe i aktorëve të tjerë në rajon e pranë tij. Sa i përket problemit tepër të rëndësishëm të programit bërthamor të Koresë së Veriut e të të ardhmes së tij, nuk mund të mos vlerësohet pozitivisht deklarimi i nënshkruar nga të dy bashkëbiseduesit, angazhimi i Koresë së Veriut për denuklearizimin e gadishullit Korean. Kuptohet, që vlerë konkrete ky nënshkrim do të marrë më pas e që do të tregojë se, vërtet do të ketë denuklearizim

apo jo. Megjithatë, angazhimi koreano-verior nuk ka se si të mos vlerësohet pozitivisht. Është më se e qartë se ky do të jetë një proces kompleks e jo një akt i menjëhershëm. Shprehja e vullnetit koreano-verior për denuklearizim, vetëm mund të vlerësohet, po të mos harrohet se kishte deri tani edhe prova me raketa, por dhe retorikë kërcënuese nga Koreja e Veriut.

Në funksion të krijimit dhe zhvillimit të besimit të munguar së tepërmi, presidenti Trump ka menduar edhe një ndërprerje të stërvitjes ushtarake të përbashkët me Korenë e Jugut, të programuar përpara mundësisë së takimit, ndoshta dhe si pjesë e strategjisë për të nxitur e shtyjë Kim Jong Un të ulët në tavolinën e bisedimeve e të heqë dorë nga kërcënimi e konfliktualiteti. Po kështu presidenti Trump edhe për realizëm, por edhe në funksion të mbështetjes së krijimit të besimit, iu referua edhe koston së mbajtjes në gadishullin Korean të një numri të lartë trupash amerikane. Kjo strategji apo filozofi politike e SHBA, duket e mundet të ketë ndihmuar në krijimin e klimës për vendimmarrjen e Kim Jong Un, që të ulët në bisedime direkte me presidentin amerikan Trump. Po kështu, ky element mund të shërbejë edhe si faktor që ushqen ecurinë e besimit e të hedhjes së hapave konkrete nga udhëheqësi koreano-verior për të vepruar në drejtim të angazhimit të premtuar për denuklearizimin. Nga këto zhvillime, përveç forcimit të sigurisë e paqes në gadishullin Korean, mund të fitojnë apo të kenë interes dhe aktorë të tjerë si Kina, që ka realisht një intensifikim të strategjisë për zhvillimin e një roli të fuqisë në Azi-paqësor.

Në fakt, SHBA ka kërkuar kontributin e Kinës në trajtimin e krizës në gadishullin Korean, por edhe për të ndërmjetësuar, që të mundësohet heqja dorë nga retorika, po edhe nga avancimi i programit bërthamor nga Koreja e Veriut, si dhe nga kërcënimet në rritje që vinin prej saj. Dhe nëse Kina ka kontribuar në këtë drejtim, këtu po fiton apo mund të fitojë siguria dhe paqja mbi të gjitha. Megjithatë, ka ndonjë prirje të mendojë se, në këtë takim e zhvillim të rëndësishëm, fituesi i madh të jetë Kina. Realisht nuk mund të mohohet që në këtë zhvillim, që pritet të zhvillohet më tej, do të fitojë mbi të gjitha siguria, stabiliteti e paqja në rajon, do të përfitojnë të gjithë aktorët e këtij rajoni dhe në këtë kontekst edhe Kina do të jetë fituese, duke llogaritur edhe objektivat gjeo-strategjike të saj në Azi-Paqësor.

Aq sa u pa dhe u lexua në elementë të ndryshëm ky takim, por dhe duke mësuar nga historia, nuk ka pse mos shpresohet e mendohet pozitivisht, pa eufori, se mund të ndodhemi realisht përpara një ndryshimi të vërtetë dhe të madh, për një të ardhme më të mirë në këtë rajon, për vetë popullin koreano-verior, për sigurinë, stabilitetin e paqen në botë. Në këtë kënd vështrimi ky takim në Singapor, nuk ka pse të mos vlerësohet një mundësi e madhe suksesi. E madhja nuk vjen menjëherë e papritur, por që mundësohet nga e vogla dhe të voglat, por mund të vijë kur shtrahet vërtet një mundësi e vërtetë, siç besohet ka ndodhur në takime e Singaporit. Pra, ka plot arsye dhe vend për të menduar pozitivisht e për të shpresuar realisht në konfigurimin e një ndryshimi e suksesi të madh, në interes stabilitetit, paqes e prosperitetit të popujve.

Nëse je vërtet realist e jo nihilist e skeptik, atëherë duhet pranuar, që një ndryshim ka ndodhur, ka filluar të ndjehet, nëse kujton provat intensive të raketave dhe kërcënimeve, apo se ishte krijari tipi i duhur i raketës për të goditur territorin e SHBA. Vërtet kostoja e lartë ekonomike që kërkonte avancimi i programit bërthamor koreano-verior, me gjithë ndihmën ekonomike të Kinës, për arsye ekonomike e të interesave gjeo-strategjike, ka rolin e vet, por dhe ky takim e ushqeu vërtet mundësinë e avancimit të ndryshimit. Presidenti amerikan Trump e bëri hapin e nevojshëm dhe tani duhet që udhëheqësi koreano-verior Kim Jong Un të bëjë hapin që i takon. Është koha dhe mundësia që udhëheqësi koreano-verior të ndryshojë më tej shumë. Kjo nuk është as vonë, por as e pamundur. Liderët e këtij formati edhe befasojnë d.m.th. që mund të bëjnë ndryshim real, që është i mirëpritur.

Më 18 qershor 2018

Opinioni *i* Ditës

Trilema monetare e Shqipërisë

Nga Gjergj Erebara

(vijon nga faja 1)

... duhet të zgjedhë mes lëvizjes së lirë të kapitalit, menaxhimit të kursit të këmbimit dhe pavarësisë monetare. Nga këto tri të mira, çdo vend është i detyruar të zgjedhë dy dhe të sakrifikojë njërin.

Një vend që dëshiron të ketë kurs fikse të këmbimit valutor, nuk mund të lejojë qarkullim të lirë të kapitalit në kufijtë e vet. Dhe nëse kursi i këmbimit është i fiksur dhe vendi dëshiron të ketë edhe qarkullim të lirë monetar (njohur në Shqipëri më shumë si llogari korrente e liberalizuar), atëherë ai nuk mund të ketë politikë monetare të pavarur. Dhe nëse një vend zgjedh llogari korrente të liberalizuar dhe dëshiron të ketë edhe politikë monetare të pavarur, ai detyrohet ta lërë monedhën e tij të luhatet sipas kushteve të kërkesës ofertës në treg.

Nga të tri elementet, mosmbajtja e llogarisë korrente të liberalizuar është më e vështira në praktikë dhe kjo, sipas "The Economist", e redukton mundësinë për të zgjedhur mes politikës monetare të pavarur dhe kursit fikse të këmbimit.

Në vitin 1992, kur Shqipëria kreu transformimin nga një ekonomi e centralizuar në një ekonomi tregu, me këshillën e Fondit Monetar Ndërkombëtar, Shqipëria zgjodhi, ose u detyrua nga kushtet e kohës për të zgjedhur kurs të lirë luhatës dhe politikë monetare të pavarur. Shqipëria mund të mbajë kurs fikse dhe llogari financiare të liberalizuar, por në këtë rast duhet të heqë dorë nga pavarësia monetare. Pavarësia e politikës monetare nënkupton të kesh mundësi të imponosh norma interesi bazë për monedhën kombëtare në përputhje me gjendjen e ekonomisë vendëse. Nëse ekonomia është në krizë dhe bankës qendrore i duhet të ulë normën e interesit, ajo mund ta bëjë vetëm nëse e ka politikën monetare.

Gubernatori i Bankës së Shqipërisë përdori këtë teori të politikës monetare në një fjalim të mbajtur të hënën në Beçiq, Mali i Zi, në një samit me krerët e politikës monetare të Ballkanit për të shpjeguar se pse institucioni i tij u duk sikur ngurroi për dy vite e gjysmë dhe në veçanti, në muajt e parë të këtij viti për të ndërhyrë në tregun e këmbimit valutor. Sipas themelit teorik të trilemës, banka qendrore që zbaton regjim kursit të lirë luhatës duhet të lejojë këtë kurs të vetëregullohet dhe të mos ndërhyjë përveçse në raste të jashtëzakonshme. Zgjedhja e pavarësisë në politikë monetare dhe e llogarisë financiare të liberalizuar duke sakrifikuar kursin fikse të këmbimit valutor nga ana e Shqipërisë në vitin 1992 u imponua



nga rrethanat e kohës. Shqipëria nuk kishte në atë kohë një rezervë monetare për të absorbuar goditje në kursin e këmbimit dhe nuk mund të shmange liberalizimin e llogarisë financiare (të drejtën e çdokujt për të sjellë ose për të larguar nga Shqipëria aq valutë sa të dojë për çfarëdo arsyeje). Shqipërisë mund edhe të mos i hynte në punë pavarësia në politikë monetare, sepse vendi nuk e kishte një të tillë dhe edhe sot që e ka, efikasiteti i politikës monetare të pavarur në ekonominë reale është shumë i dyshimtë. Por duke qenë se liberalizimi i llogarisë korrente ishte i pashmangshëm dhe vendi nuk kishte mundësi të mbante një kurs fikse këmbimi, pavarësia e politikës monetare nuk ishte, gjithashtu, çështje zgjedhjeje.

Në të gjitha rastet, kjo trilemë e politikës monetare duket se nuk e zbhën situatën e çuditshme në cilën gjendet Shqipëria, ku monedha kombëtare, leku, është forcuar me tepri kundrejt euros dhe ku forrimi po interpretohet nga BSH si fenomen psikologjik, i shkaktuar nga "pritsmëritë" një eufemizëm për panikun pa përdorur fjalën panik. Se sa prej forcimit të lekut gjatë këtij viti i detyrohet "pritsmërive" apo panikut për forcim të mëtejshëm të lekut dhe sa është pasojë e tepricës së euros në treg, kjo është një çështje

tjetër. Por sa i përket trilemës monetare, fakti është që një vend mund të zgjedhë jo vetëm kurs luhatës këmbimi valutor, por edhe një gamë të gjerë politikash të ndërmjetme. Shumë banka në Ballkan dhe në Europën Lindore kanë zgjedhur politika të tilla, duke njozur rëndësinë që ka kursi i këmbimit të stabilitetit i çmimeve. Stabiliteti i çmimeve, në rastin e Shqipërisë, objektivi i politikës monetare për inflacion në masën 3%, është arsyeja e ekzistencës së bankave qendrore.

Vende të ndryshme të botës kanë zgjedhur të sakrifikojnë kursin fikse të këmbimit valutor duke lënë monedhat e tyre të luhaten sipas kushteve të tregut përballë dollarit amerikan. Kjo i mundëson, fjala vjen Kanadasë, të përcaktojë interesat e saj e pavarur nga fuqia e dollarit amerikan. Eurozona ka ndjekur këtë kundërtën, ka sakrifikuar politikën monetare në këmbim të kursit fikse të këmbimit valutor, kurs i shprehur nga euro.

Vendet e Ballkanit kanë bërë zgjedhje të ndryshme. Bullgaria, Maqedonia e Bosnja kanë zgjedhur kurs fikse me euro. Kroacia ka zgjedhur politikën e "luhatës së menaxhuar të kursit të këmbimit", politikë që nënkupton ndërhyrjen në të dyja krahet pothuajse çdo ditë nga banka qen-

drore për të shmangur si forcimin ashtu edhe dobësimin afatshkurtër të monedhës vendëse, me kushtin që tendenca afatgjatë mbiçmuese apo nënçmuese të respektohet. Banka qendrore e Kroacisë thotë të lidhje me këtë politikë: "Kuai i politikës monetare të Bankës Kombëtare të Kroacisë bazohet në ruajtjen e stabilitetit të kursit nominal të këmbimit të kunës kundrejt euros. Një kurs i qëndrueshëm këmbimi përbën të ashtuqajturën ankormit të politikës monetare përmes të cilës banka stabilizon pritsmëritë inflacionare dhe, në instancë të fundit, vetë inflacionin."

Serbia ka pasur kurs të lirë luhatës dhe zyrtarisht vijon ta ketë të tillë, por Fondi Monetar Ndërkombëtar thotë se Serbia efektivisht nga fillimi i vitit 2016 është në regjimin e kursit të menaxhuar luhatës. Polonia ruan kurs luhatës, por rezervon të drejtën "për të ndërhyrë në rast se kursi dëmton objektivin e saj në politikë monetare".

Shembujt e përmendur më sipër e lidhin kursin e këmbimit me objektivin e inflacionit në shumë raste. Banka e Shqipërisë bën një përjashtim, pasi nuk e përmend kursin e këmbimit si të lidhur me objektivin e saj për ruajtjen e inflacionit në masën 3%.

Reporterat

HOROSKOPI

DASHI

Mëmi pak kohë për tu menduar mbi mundësitë e reja profesionale, që ju janë ofruar. Më mirë të mos mendim vendime bazuar mbi entuziazmin momental. Nëse vazhdoni të mos ndiheni në lartësinë e duhur në disa situata, ashtu do të dalë me të vërtetë. Me shumë optimizim!

DEMI

Të kënaqur me surprizat e dhuruara nga Jupiteri që bashkëvepron me Uranin do të jeni shumë aktiv. Sot me të vërtetë do t'ia kaloni bukur! Do të keni dëshirë t'i përkushtoheni studimit të lëndëve të reja, mbi të gjitha preferoni shkencën dhe matematikën.

BINJAKET

Plutoni parashikon vështirësi. Do të ndiheni nën trysni nga një sërë angazhimesh që do të kenë. Do të shfaqen rivalitete dhe konkurrenca. Në familje pritet shumë nga ju dhe kjo ju vendos në vështirësi, duke bërë që të mos jeni tolerant.

GAFORJA

Sot jeni të dashur dhe të shoqërueshëm dhe do të keni raporte më të mira me familjarët dhe miqtë. Dhe me Uranin që ju favorizon, do të tejkaloni vështirë që do t'ju dalin. Për ata që janë beqarë, pritet të ketë një takim që do t'ju ngjallë emocione të mëdha.

LUANI

Gjatë ditës së sotme nuk do të jeni në humor të mirë. Do të kundërshtoni çdo gjë që ju thonë, por mos e ekzagjeroni. Do të jeni i tendosur dhe personi i zemrës do të vendosë t'ju shpërfillojë, duke ju lënë të vetëm të tejkaloni shqetësimin që keni.

VIRGJERESHA

Jupiteri, që ju favorizon, bëhet zëdhënës i lajmeve të mira, ftesa dhe risi të këndshme. Do të ndjeni emocione të këndshme të papërshtueshme. Do të bëni disa ndryshime në shtëpi dhe gjithçka do të jetë edhe më e bukur se më parë.

PESHORJA

Mos e lini t'ju ikë një mundësi të bukur takimi për shkak të bindjes se nuk u përshatani mjediseve të caktuara. Sigurisht që jeni i përshatshëm. Provojeni që të besoni. Do të rropateni për të gjetur një ekuilibër midis lirisë vetjake dhe punës, por në fund do t'ia dilni.

AKREPI

Bashkëveprimi i Plutonit me Uranin do t'ju nxisë të shfrytëzoni sugjerimet që mëmi dhe do t'ju shtyjë të shprehni krijimtarinë tuaj. Në dashuri do të përjetoni atë ndjesi intimiteti dhe përkatësie që ju emocionon e që ju dhuron qetësi.

SHIGJETARI

Ditën e sotme do të jeni autoritarë dhe konkretë. Por, për shkak të kundërshtive të vogla, do të përjetoni momente të mira e të këqija. Dorsozhoni përpara faktive, zemra ju rreh fort për një person të veçantë, që deri më tani e keni shpërfillur.

BRICJAPI

Bashkimi i Hënës me Saturnin do të nxisë prirjen për t'u mbyllur në vetvete, duke mos shfaqur emocione dhe ndjenja. Sot jeni të shpërqendruar dhe nervozë, por për fat, humori i keq është i përkohshëm dhe dielli do të ndriqojë.

UJORI

Është dita e duhur për të kaluar momente të mira jashtë qytetit me miqtë. Dikush do t'ju bëjë të andërroni, do t'ju marrë për dore dhe do t'ju çojë në "vende" të shpirtit që nuk i keni njohur më parë. Kjo është mundësi e mirë për të gjetur personin e zemrës.

PESHQI

Së bashku me Uranin, Mërkuri premtim mrekulli. Është qershia mbi tortë për ata që duan të përballen me një detyrë të rëndësishme në punë apo një provim. Jeni i kthjellët në mendime dhe keni një vizion të qartë për të ardhmen. Do ta doni atë që është risi.



Tunizia rezistoi deri në kohën shtesë

Herri Kejn shpëton Anglinë në kohën shtesë

Herri Kejn ka shpëtuar Andërin e Anglisë me golin e tij në shtesën e sfidës ndaj Tunizisë, duke i dhënë suksesin 2-1 britanikëve të drejtuar nga Gareth Sauthgejt. Një ndeshje që dukej si shëtitje për anglezët, për pak sa nuk u

kthye në makth për ta, pasi Tunizia i bëri ballë mjaft mirë dhe vetëm kapiteni me dygolëshin e tij e ktheu në rrugën e duhur duke siguruar tri pikët në duelin e parë. Por ndërsa anglezët shpërdoruan shumë raste, skuadra

e Tunizisë arriti të fitonte një penallti pas gafës së Uoker, i cili goditi në zonë një kundërshtar. Sasi nuk gaboi nga pika e bardhë për tunizianët, duke vendosur barazinë në shifra. Sulmet angleze vazhduan dhe ata iu afruan përsëri golit, si-

domos në fund të pjesës së parë kur Lingard goditi shtyllën. Minutat po kalonin dhe goli, pavarësisht dominimit anglez, nuk dukej në horizont, duke lënë të mendohej se kjo do të ishte surpriza e ardhës e këtij Botërori. Megjithatë, gjërat ndryshuan në minutën e parë shtesë të sfidës, kur pas një goditje nga këndi, "Urangani" ishte në vendin e duhur për të shtyrë topin në rrjetë e për t'i dhënë suksesin skuadrës së tij.



Jeton Selimi

Fraksioni i parë mbyllet 0-0 dhe pa goditje në portë, më pas "djajtë" shpërthyen në 45 minutat e dyta

Belgjikë me "tri yje", Panamaja rezistoi vetëm një pjesë loje

Mertens dhe Lukaku me dy gola vulosën ndeshjen



Askush, madje as vetë lojtarët belgë nuk do ta kishin menduar që do të hasnin kaq shumë vështirësi. Panamaja bën rezistencë, ndërsa Belgjika nuk arrin të gjejë pasimin vendimtar në gjithë gjysmën e parë të takimit. Në minutën e 12-të Hazar nuk përfiton nga gabimi i Ramon Torresit që kthen keq për portierin, ndërsa të besuarit e Martinezit nuk arrijnë të ekzekutojnë siç duhet një skemë nga kornia, me Mertens që gjuan jashtë. Në të 22-ën është De Bryn që provon nga distanca, por edhe ky pa koordinatat e duhura. Provojnë sërish "djajtë kuqezi" katër minuta më pas. Hazar bën gjithçka vetë, por guajtja e tij nuk kërcënon portën e Penedos. Panamaja shfaqet për herë të parë vetëm në minutën e 35-të, kur Koper gjen Rodrigezin në zonë, por mbyll në këndore mbrojtja belge. Hazar përpigjet dhe njëherë në minutën e 38-të, kur shërbehet nga Munie në zonë, gjuan fort, por Penedo grushton në këndore. 3 minuta më pas edhe njëherë Belgjika që provon. De Bryn harkon nga goditja e denimit, Mertens gjuan fluturimthi me topin që del ngjitur me shtyllën. Pjesën e parë e mbyll Panamaja në sulm, me Koperin që provon të befasojë Kurtuan nga largësia, por asnjë kërcënim. Me rrjeta të pa-

prekura përfundoj fraksioni i parë, ndërsa në të dytin Belgjika e korrigjon shënjestrën menjëherë. Minuta e 47-të. Krosim nga e djathta dhe në largimin e topit me kokë nga Eskobar, vjen Mertens që fluturimthi gjuan shkëlqyeshëm dhe e çon topin në trekëndëshin e largët. Panamaja përpigjet të

reagojë dhe në minutën e 54-të mund të kishte befashuar belgët, nëse Murijo do të ishte më gjakftohtë përballë Kurtuas, që mbyll pasqyrën e portës. Shfaqet sërish Panamaja pak caste më vonë, por Barcenat nuk do ta kërcënojë kuadratin e Kurtuas. Belgjika kërkon golin e dytë dhe do të hedhë shumë

topa në zonë, por gjithçka do të konkretizohet në minutën e 69-të, kur De Bryn vallëzon në zonë dhe me të jashtmen e së djathtës pikturon një assit për Romelu Lukakun, që me kokë nuk gabon duke dyfishuar rezultatin. 2-0 dhe Belgjika çlirohet. Madje do të shënojë prapë vetëm 6 minuta më

BOTERORI RUSI 2018		
Grupi F		
Meksikë - Gjermania	1	0
Suedi - Korea e Jugut	1	0
Renditja		
Skuadra	N	P
Meksika	1	3
Suedia	1	3
Gjermania	1	0
Korea e Jugut	1	0

pas. Sërish me Romelu Lukakun, që finalizon mjaft mirë një kundërsulm të Belgjikës. 3-0 dhe sfida është në kasafortë. Belgjika ul ritmin, ndërsa Panamaja përpigjet të shënojë golin historik. Madje mund ta kishte realizuar nëse Tehada do të ishte pak më i shpejtë. Në fund dhe një tjetër mundësi me Eskobar, që shkarkon të djathtën, por bllok në shtyllën e parë Kurtua. Përfundon 3-0 ndeshja për Belgjikën, që siguron tre pikët e para në këtë Kupë bote.

GRUPI H



Japonia kërkon të befasojë Kolumbinë

Japonia do të ndeshet me Kolumbinë dhe trajneri Akira Nishino kërkon që ta lërë të gjithë presionin te trajneri rival. "Pekermani ka katër vite në krye të ekipit, unë kam pak javë dhe kjo është një diferencë e madhe. Kam përgatitur çdo gjë që munda për lojtarët dhe mendoj se kjo është e mjaftueshme. Unë jam besimplotë për ndeshjen e së enjtes".

Nërkohë, trajneri Pekerman deklaroi se për Kolumbinë, kësaj radhe është më e vështirë sesa në Brazil katër vite më parë. "Në Brazil kishim më shumë lojtarë me peshë, ndërsa tani kemi rinovuar shumë ekipin dhe kemi më shumë mundësi taktike. Është diçka normale, jemi përpjekur për të krijuar shanset tonë në këtë Kupë Bote".

RUSI-EGJIPT

Stanislav Çerçesov beson dhe shpreson se Rusia do të arrijë suksesin e dytë kundër Egjiptit. Gjithsesi trajneri i druhet Mohamed Salah dhe kërkon kujdes nga lojtarët e tij. "Jemi mirë dhe jemi në humor. Ishim më nervozë në ndeshjen e parë. Tashmë duhet të mendojmë për Egjiptin dhe duhet ta kalojmë edhe këtë pengesë. Lojtarëve të mi u kërkoi të kenë kujdes Mohamed Salah, por jo vetëm

Çerçesov do fitoren e dytë, Kuper me sytë nga Salah

atë pasi Egjipti nuk është vetëm Salah". Por ndryshe e mendon sulmuesi Dmitri Cerishev, që ka zhvlerësuar disi sulmuesi egjiptian. "Salah është një lojtar shumë i mirë, por nuk është një yll botëror. Ai nuk është as Mesi e as Ronaldo". Por të gjithë në Egjipt presin Mohamed Salah, ndaj për-

jashtim nuk bën as trajneri i faraonëve, Hektor Raul Kuper. "Salah është në formë të mirë, por gjithsesi rezervohemi disi dhe do të kalojë një test tjetër të rëndësishëm përpara ndeshjes. Por ai kërkon të luajë dhe unë jam i bindur se ai do të luajë, pasi është në qendër të ekipit".

TRAJNERI POLAK

Sfida e fundit e mbrëmjes do të jetë ajo mes Polonisë dhe Senegalit. Trajneri polak, Adam Nawalka shpreson të rikuperojë qendërmbrojtësin Kamil Glik, një nga pikat e forta të skuadrës. "Nuk e di në do t'ia dalë. Duhet ta shohim me vëmendje situatën e tij para ndeshjes. Duhet të jemi në formën më të mirë për ndeshjen e parë në këtë Kupë Bote".




Ndërsa trajneri më i ri i këtij Botërori, Aliu Cise, deklaroi se Senegali i tij nuk ka pre-

Polonia pa Glik, Senegali shpreson

sion. "Është e rëndësishme që të debutojmë mirë, por nuk është kapitale. Senegali është një nga ekipet më të mira të afrikës. Jemi të vendosur dhe nuk kemi komplekse. Nuk kemi presion, ndonëse kemi punuar shumë fort për të qenë këtu".

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

1. Steiger aktor.
4. Mbetet në fund.
6. Ustinov i kinemasë.
11. Janë në modë.
12. Nuk e shqyen Danielin.
15. Një as i Milan.
16. Çobani aktore e jona.
18. I dyti në kapitull.
19. Dy asa në dorë.
21. Qe njeriu i parë që u dënua padrejtësisht.
23. Croft e Angelina Jolie.
24. Një që mbahet për mondan.
25. Para De Janeiro-s.
27. Gjysmë tandem.
29. Kap ndryshe.
30. Gjysmë tatimi.
31. Union Stutendor Operativ.
33. Wallach aktor.
35. Pak spiunazh.

37. Ishin hipokritët e Jezu Krishtit.
38. Ai dhe ajo.
40. Një Madame e Maupassant.
41. Këshu thirrej Ernesto Guevara.
42. Fund ditari.
43. Pije piratësh.
45. Kush e thotë refuzon.
46. Të parat në sondazh.
47. Një makinë franceze.
48. Fillojnë stafetën.
49. Nisin nga fillimi.
50. Qan te Turandot.
51. Fundi i një samurai.
52. Umberto qe shkroi Lavjërësi i Foucault.
53. Dalë në krye.

VERTIKAL

1. Ajo e tretë u quajt Moskë.
2. Një hyrje të odës.
3. Me me për të penduarin.
4. Para... Gay në aeroplanin që hodhi bombën atomike në Hiroshimë.
5. Jepet për hartim.
7. Lindi edhe Cerberin.
8. Mbyllin pora.
9. Gjysma e ekipit.
10. N një inkursion me mig.
12. Fillojnë lehtë.
13. Eshhtë tretës me zorrë.
14. Pak tematike.
17. Qe mbreti jetëgjatë i Pilos.
20. Eshhtë ndalim me pranga.
22. Shkroi Këngëtarja tullace.
23. Eshhtë pikë vaji.
26. Ndajnë shtetet.
28. Kush nuk ka... s'eshhtë njoftuar.
32. Poetja e Lesbos.
34. Këshu shprehet komisar Rex.
36. Fillojnë panikun.
38. Një liqen i kripur.
39. Inva soprano.
43. Inicialet e Altman.
44. Një fjalë për sipër.
46. Të parat në stadium.
47. Fillojnë turnin.
48. Një hyrje të sokakut.
49. Fillojnë nazet.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


3. Një pune... paguhet.
6. Para Zeppelin në grupin e famshëm.
8. Vincenzo, bomber te Roma.
12. Kufijtë e pritjes.
13. Një Arthur i Edgar Allan Poe.
16. Demek s'ka kufij.
18. Qe filozofi i shkollës eleatike.
19. Nino, kompozitor i famshëm italian.
21. Eshhtë ai që ka ngrityr krye.
23. Finlanda e... finlandezeve.
25. Mbledh basketë separatistë.
26. Inicialet e Prost.
28. Shkroi Cocktail party.
29. Titulli i Alex ferguson.
30. Stile pa kufij.
32. Ishin greket që nuk vinin kurrë.
35. Unë dhe ti.

VERTIKAL


7. Një pjesë e dimensioneve.
8. Fillojnë muzikën.
9. Parafjala e prejardhjes.
10. Fernando, bomber i Liverpool.
11. Bisha aktore.
12. Ishin ushtarë të Kserksit.
14. Partia Demokratike.
15. Cepat e një ylli.
17. Ylli i baletit.
22. Mbushin enë pa fund në ferrin dantesk.
24. Italia në Internet.
27. Përhapet me frikë.
31. Mund të jetë françeskan.
33. Dëhin pa kufij.
34. Eshhtë lënda për... ratte.
37. Gjysmë sahati.
39. Tatum që qe pianist.
40. Lloj papagalli.
42. Një pikë vaji.
44. Artikulli spanjoll.
45. Një krye të socialistëve.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

7			9	3				
5							6	1
		9	1					
6		8			7			9
			2	3		4		6
3								5
	8				9			4
2		5			4		7	
		6						8

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

6	5	9	2	3	4	7	8	1
8	2	3	1	7	5	6	9	4
7	4	1	6	8	9	2	3	5
9	6	4	3	2	7	1	5	8
5	7	2	8	4	1	9	6	3
1	3	8	5	9	6	4	7	2
2	8	7	4	6	3	5	1	9
3	9	5	7	1	2	8	4	6
4	1	6	9	5	8	3	2	7

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Argëtim filozofik

- Argumentet serioze të kundërshtrartit t'i refuzoni me humor, ndërsa shakatë, seriozisht.
Kushdo që do, shpreson, kushdo që shpreson pret, kushdo që pret këmbëngul, kushdo që këmbëngul fiton.
- Kur një person dëshiron të bëjë humor, ata përreth tij duhet të jenë po aq inteligjentë me të, përndryshe ata nuk do ta kuptojnë.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm

5	1	7	2		7	3		13		2		
2	7	5			8	4	3	5	7	2	6	
7		3	1	9	1	6	5	10	6	2	6	
		3	5	8	2	3	5	6	1	7	5	
12	5	13	5	10	1	7		6		13		
2	7	18			5	11	2	6	5	8	2	6
8	2	6	2		2		1	8	5	11	1	
1	6	8		17	9	5	7	2			9	
5	1	5		8	2	16			2	7	1	
2				3	2	6	5	9	2		1	13
6	2	7	2			5		7	18	3	6	7
3	4	8	5	19	1	5			3	5	2	

M	I	K	E		K	M	S		E		
E	K	A			R	O	M	A	K	E	T
K	M	I	L	I	T	A	N	T	E	T	
M	A	T	E	M	A	T	I	K	A		
P	A	S	A	N	I	K		T	S		
E	K	U		A	N	E	T	A	R	E	T
R	E	T	E		E	I	R	A	N	I	
I	T	R		B	L	A	K	E		L	
M	I	A		R	E	D		E	K	I	
E				M	E	T	A	L	E	I	S
T	E	K	E		M	K	U	M	T		
M	O	R	A	V	I	A		M	A	E	

Thënie të mënçura

- Të qeshësh me gabimet e tua, të zgjat jetën. Për të qeshësh me gabimet e të tjerëve, mund të ta zvogëlojë.
- Një fëmijë hyn në shtëpinë tuaj dhe bën aq zhurmë për njëzet vjet, e cila është e vështirë të durohet. Pastaj, largohet duke e lënë shtëpinë aq të heshtur sa që mendoni se do të çmendeni.
- Dështimi i përgatitjes është përgatitja e dështimit.

PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

A	R	K	A	A	S	T	R	O	A	M	A
D	I	A	N	A	H	I	A	N	I	K	
A	T	L	A	N	T	I	K	E	O	L	S
P	E	I	T	A	R	I	F	A	T	L	E
T	T	P	O	L	I	T	I	K	A	N	E
K	E	N	E	T	A	O	R	A	R		
P	A	U	L	I	N	R	R	I			
A	S	E	Q	T	A	D	D	I	N		
B	E	N	U	N	E	K	T	E	R	A	
E	T	J	I	T	E	R	I	A	M	A	N
T	E	I	A	R	O	N	A	N	E		
I	N	T	A	R	O	N	A	N	E		

FJALËKRYQI (2)

P	A	B	M	E	L	E	R	G	O			
R	K	U	P	A	D	E	M	I	R	A	T	E
O	H	A	R	A	D	A	R	O	M	A	T	
C	I	K	L	I	S	T	E	T				
S	T	A	D	I	U	M	E	T	A	P	E	L
D	I	K	A	S	T	E	R	E				
K	E	N	T	N	G	O	P	J	E	V		
K	A	R	I	A	S	T	E	S				
A	R	S	T	I	O	L	A	T	R			
M	A	N	S	T	I	O	Z	A	N	O	R	E
A	M	A	N	A	N	A	N	A	N			
T	T	E	R	R	E	N	I	E	I	N	E	

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL

GSH

www.gsh.al

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

Tashmë edhe lundroni!

